

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit MSc në “Shkenca Komunikimi”, në profilet

a) “Marrëdhënie me publikun” dhe b) “Gazetari”

Kolegji Universitar BEDER

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:



Dr. Arben MUKA



Dr. Diana KALAJA



Prill 2019



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në “Shkenca Komunikimi”, në profilet:

a) “Marrëdhënie me publikun” dhe b) “Gazetari”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “BEDER”
2	Departamenti përgjegjës/ Fakulteti që e ofron	Departamenti i Shkencave të Komunikimit Fakulteti i Shkencave Humane
3	VKA/Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKA Nr. 165, datë 15.04.2011 UMASH Nr. 10, datë 16.01.2012
	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VKA Nr. 469, datë 03.05.2013 (Pozitiv, me rekomandime:) Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013
4	Plotësimi i rekomandimeve	Shkresë Nr. 72/1 prot, datë 04.11.2013
5	Regjistrimi i formës së Diplomës	Urdhër të MAS Nr. 61, datë 09.02.2016, ndryshuar me Urdhër të MAS Nr. 420, datë 20.09.2017
6	Titulli i programit të studimit:	MSc në “Shkenca Komunikimi”, në profilet a) “Marrëdhënie me publikun” dhe b) “Gazetari”
7	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
8	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
9	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
10	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
11	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
12	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
14	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve aktualë	a) “Marrëdhënie me publikun” 112 Studentë b) “Gazetari” 6 studentë

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi, në profilet:

- a) "Marrëdhënie me publikun"
- b) "Gazetari",

i Kolegjit Universitar "BEDER" është licencuar me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 10, datë 16.01.2012 dhe sipas VKA Nr. 165, datë 15.04.2011.

Programi i studimit është vlerësuar në kuadër të akreditimit të parë dhe me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 469, datë 03.05.2013 dhe Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013 është akredituar Pozitiv, me rekomandime.

Ky Raport i Vlerësimit të jashtëm është hartuar në kuadër të akreditimit periodik.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Dr. Arben Muka
- Dr. Diana Kalaja

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxheri teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 30.03.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 6/38 Prot., datë 02.04.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", KUB është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 03.04.2019, "KUB" përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft –Raportin, me shkresë Nr. 126 Prot., datë 03.04.2019 "Komente rreth draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Msc në "Shkenca Komunikimi, në profilet: a) "Marrëdhënie me publikun"; b) "Gazetari".

Në këtë dokument institucioni nuk ka bërë komente për Draft-RVJ dhe është dakort me vlerësimin. Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit në akreditimin e parë

- a) Të qenurit institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës, të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qendrueshmëri dhe besueshmëri.
- b) Të përmirësohet numri i pabalancuar midis personelit efektiv dhe atij me kontratë.
- c) Të rritet numri i personelit akademik efektiv, sipas fushave të veçanta të specializimit.
- d) Të përfshihet në planin mësimor disiplina e Gjuhës shqipe, e nevojshme për studentët që nuk kanë njohuri për të në formimin bazë.
- e) Të rritet numri i titujve në bibliotekën e institucionit, periodikëve të huaj, si dhe sigurimi i teksteve bazë në disa disiplina.
- f) Të krijohen mjedise sportive për studentët.

- g) Të krijohet mundësia për përfshirje të institucionit në nismat e BE-së.
- h) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e teksteve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të qenurit një institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri” gjatë vizitës dhe takimeve u vu re se Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka përfshirë në grupin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm emra të njohur nga fusha e gazetarisë në vend, kryeredaktorë të televizioneve kombëtare, ekspertë dhe analistë të shtypit të shkruar. Kjo ka sjellë krijimin e një ambienti me standartet profesionale. Studentët kryejnë praktikrat dhe internship në mediat më të njohura në vend. Gjithashtu Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi me pedagogë të jashtëm dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, dhe ka plotësuar në këtë mënyrë nevojat për studentët e këtij Departamenti, duke u bërë një qendër dinamike që reflekton zhvillimet në tregun mediatik në vend dhe më gjerë. s
- b) Për rekomandimin “Të përmirësohet numri i pabalancuar midis personelit efektiv dhe atij me kontratë”, u vëzhgua se KUB ka rritur numrin e pedagogëve në Departament. Ndër vite personeli i departamentit është plotësuar me pedagogë. Një tjetër personel efektiv ishte shtuar me fillimin e vitit mësimor 2018-2019. Rekrutimi është bazuar në procedurat përkatëse. Departamenti planifikon të zgjerohet me personel të ri. Për lëndë specifike janë përzgjedhur edhe forma bashkëpunimi me lektorë me kontratë. Kjo pasi vete natyra e shkencave të komunikimit kërkon edhe bashkëpunim me zëra të njohur të medias. Rekomandim i plotësuar
- c) Për rekomandimin “Të rritet numri i personelit akademik efektiv, sipas fushave të veçanta të specializimit”, Departamenti ka bërë një shpërndarje të lëndëve mësimore tek pedagogoet në vartësi të specialitetit të tyre. Kjo është e lidhur edhe me afrimet e reja të pedagogëve efektivë në Departament dhe në Kolegjin Universitar BEDER. Rekomandim i plotësuar
- d) Për rekomandimin “Të përfshihet në planin mësimor disiplina e Gjuhës shqipe, e nevojshme për studentët që nuk kanë njohuri për të në formimin bazë”, Departamenti ka punuar dhe rishikuar syllabuset e lëndëve. Lënda e Gjuhës Shqipe zhvillohet e plotë në ciklin Bachelor duke plotësuar mangësitë që studentet mund të kenë nga formimet e tyre paraprake në arsimin parauniversitar. Departamenti organizon workshope për rishikimin e programit të lëndëve. Gjithashtu Departamenti ka një Komitet Teknik i cili orienton për lëndë dhe syllabuse. Mendojmë që lënda e Gjuhës shqipe nuk është e nevojshme në Masterin Shkencor si lëndë më vete, por elementë të saj mund të jepen si pjesë në lëndë të tjera. Rekomandim i plotësuar
- e) Për rekomandimin “Të rritet numri i titujve në bibliotekën e institucionit, periodikëve të huaj, si dhe sigurimi i teksteve bazë në disa disiplina.”, Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon me Institutin Shqiptar të Medias si edhe merr tekste bazë ndërkombëtare që janë përkthime të teksteve kryesore të gazetarisë. Fashikuj të veçante përdoren edhe në lëndët praktike të gazetarisë. Për tekstet e nevojshme për programin “Bachelor” dhe “Master i shkencave”, në Shkencat e Komunikimit pranë bibliotekës së Kolegjit Universitar BEDER është një listë e gjerë me tituj botimesh të cilët mund të shfrytëzohen nga studentët. Në bibliotekë është shtuar numri i titujve si në gjuhën shqipe, anglisht, turqisht. Një pjesë e mirë janë tituj bashkëkohor. Gjithashtu Biblioteka ka edhe formatin online të kërkimit të librave. Gjatë dy viteve të kaluara studentët u përfshinë në një nismë “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, tillë ishte dhe fushata e studentëve të programit “Master”, për pasurimin me libra të Bibliotekës së Universitetit. Si pasojë e saj bibliotekës së KUB iu shtuan rreth 10,000 libra të rinj. Po kështu, Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit tetor 2018, ka dhuruar mbi 3000 libra të rinj. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 2018 libra ishin botime specike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Ky rekomandim është plotësuar

- f) Rekomandimi “Të krijohen mjedise sportive për studentët” është plotësuar. Në mesin B ka një sallë të re palestre dhe ushtrimi për aktivitetet sportive për studentët.
- g) Rekomandimi “Të krijohet mundësia për përfshirje të institucionit në nismat e BE-së, është plotësuar kryesisht. Nevojitet që KUB dhe Departamenti të punojë më tej për t’u përfshirë në programet e shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve.
- h) Rekomandimi “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e teksteve të njohura ndërkombëtare.” KUB e ka kriter njohjen e një gjuhe të huaj, anglisht ose një nga gjuhët e tjera kryesore të BE për të bërë procesin e regjistrimit në programin Master. Kështu që konsiderohet rekomandim i plotësuar.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane ka ngritur programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi; profili Gazetari dhe profili Marrëdhënie publike, i cili shtrihet në dy vite akademike, (katër semestra) dhe përmban gjithsej 120 ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive). Ky program studimi ka për qëllim t’u ofrojë studentëve një formim të avancuar thelluar shkencor dhe intelektual, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptesh dhe perspektiva në fushën e komunikimit, gazetarisë, marrëdhënieve publike e në fusha të ngjashme me to.

Programi “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” ofron studime të avancuara në fushën e shkencave të komunikimit e të medias duke i prezantuar studentët me llojshmëri konceptesh. Objektivat e programit Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike, të parashtruara edhe në RVB renditen si më poshtë:

- Përgatitja e profesionistëve në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut;
- T’u japë të diplomuarve arsimim dhe trajnim të thelluar në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- T’u krijojë atyre një qasje të re për komunikimin masiv në Shqipëri, në përputhje me përvojën dhe konceptet evropiane e botërore në këto fusha studimi e veprimi;
- Të përpiqet për të realizuar një status të ri të specialistit të komunikimit me mediat e me publikun, në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore që janë krijuar në ditët e sotme;
- Programi shtron alternativa konkrete për zhvillimin e medias në bazë të strategjisë kombëtare dhe jep prej vitesh ndihmesën e vet për krijimin e një elite të re të komunikimit masiv dhe të marrëdhënieve publike;
- Kualifikim i thelluar shkencor i studentëve me njohuri të zgjeruara në fushën e Gazetarisë e të Marrëdhënieve me publikun dhe të komunikimit në tërësi;
- Rritja e profesionalizimit në drejtim të kërkimit shkencor në fushat ku ofrohet ky program studimi;
- Të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në media dhe në sektorin e marrëdhënieve me publikun;
- Të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e gazetarit apo të zëdhënësit për mediat, e për të informuar publikun në tërësi;

- Të kuptojnë dhe pasqyrojnë diversitetin e individëve dhe atë kulturor në shoqëri si edhe impaktin e tyre në marrëdhëniet publike;
- Të kuptojnë konceptet dhe të aplikojnë teoritë e komunikimit në procesin e përgatitjes së materialit për publikim;
- Të kuptuarit dhe të demonstruarit të etikës profesionale; zhvillimin e të menduarit kritik dhe të pavarur;
- Të tregohen kompetentë në rolin që do të marrin në fushën ku do të angazhohen;

Përcaktimi i këtyre objektivave është në përputhje me misionin dhe objektivat themelore të KUB dhe Departamentit. Në vizionin e tij Departamenti i Shkencave të Komunikimit synon të përgatisë profesionistë të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe zhvillimi të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit dhe të medias. Departamenti synon të bëjë një ndërthurje të aftësisë teorik dhe praktik të studentëve.

Kolegji Universitar BEDER ka strategjinë e tij të zhvillimit institucional. Plani Strategjik institucional 2018-2023 ka përcaktuar edhe objektivat strategjike. Objektivat janë të detajuara edhe me nisma për konkretizim. Mbështetja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete kërkimore-shkencore dhe mbështetja e inovacionit dhe ideve të reja.

KUB ka të miratuar edhe një rregullore të kërkimit shkencor BU-DIR-004-AL e publikuar në 01.10.2012. Kjo rregullore jep edhe klasifikimin sipas një sistemi pikëzimi të kërkimit shkencor, pjesëmarrjes në konferenca dhe botimet të librave. Departamenti i Shkencave të Komunikimit shërben si bërthama e kërkimit shkencor në fushën e medias. Po ashtu Departamenti, si pjesë e Fakultetit ka organizuar edhe disa konferenca ndërkombëtare me referues të vendit si edhe nga vendet e rajonit. Në seanca, panele apo workshope ka patur edhe referues studentë dhe studiues të rinj. Në ndihmë të studentëve është edhe kolana e seminareve “Studenti dhe profesioni” me takime me figura mediatike dhe gazetarë aktivë në mediat e vendit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit respekton rregulloret e brendshme të Kolegjit Universitar BEDER, duke reflektuar misionin e KUB për t’u dhënë studentëve një edukim cilësor. Po ashtu Departamenti ka ndërtuar objektivat e programit të studimit Master bazuar edhe në një studim tërësor të tregut mediatik i cili detajon situatën aktuale të medias dhe drejtimit e mundshme të evoluimit të tregut mediatik në vend. Në ndërtimin e programit dhe të kurikulave janë parë edhe zhvillimet e reja të medias me mediat sociale që po lindin.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” ka të ndërthurur lëndët teorike bazë dhe u jep mundësinë studenteve që nëpërmjet programeve praktike, dhe studios multimediale dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të krijojnë mundësinë e ballafaqimit të dijeve teorike me realitetet aktuale në vend.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Në kuadër të projekteve ekstrakurikulare dhe</p>

	klubeve studentore, në vitin akademik 2017-2018, klubi i leximit të studentëve realizuan një projekt “Një libër më shumë për Preshevën”. Në kuadër të këtij projekti u grumbulluan libra në gjuhën shqipe dhe mjeteve shkollore për fëmijët e luginës së Preshevës. Në maj 2018 librat u dorëzuan në komunën e Bujanocit nga një grup me përfaqësues nga studentë dhe pedagogë nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe KUB.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	<p>Që në fillimet e KUB Departamenti i Shkencave të komunikimit ka qenë mjaft aktiv dhe programet që ai ka ndërtuar kanë qenë në përshtatje me objektivat themelore të zhvillimit të institucionit. Edhe kurikula ka reflektuar eksperiencën që KUB ka formuar, dhe fakti që zëra të fuqishëm nga tregu mediatik në vend janë pedagogë në KUB. Programi përmban lëndë të grupeve teorike dhe formimit themelor.</p> <p>Aktualisht KUB ka ndërtuar një Plan Strategjik 2018-2023, i miratuar nga Senati në mars 2018. Edhe objektivat Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” janë në të njëjtën linjë me objektivat e pasuruara të këtij Plani për zhvillimin e institucionit 2018-2023.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” i KUB është hartuar në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi dhe aktet nënligjorë të përcaktuar me udhëzime nga MASH. Ky program respekton ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe me “Procesin e Bolonjës”. Programi bazohet në Udhëzimin Nr. 4, datë 22.01.2008 “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë”, në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.</p> <p>Struktura e programit, kontrolli i dijes dhe vlerësimi I saj janë të përcaktuara në rregulloren e hartuar për këtë program studimi</p> <p>Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur në përfundim të programit të studimit. Ky emërtim përshtatet edhe me përcaktimet e dhëna nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (niveli i studimit për diplomat Master). Ai përshtatet me kuadrin e tre cikleve të studimit të përcaktuara sipas rregulloreve dhe akteve nënligjore në fuqi. Programi Master renditet në nivelin 7 në kornizën shqiptare të kualifikimit</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>KUB ka hartuar dhe miratuar edhe Strategji për zhvillimin e institucionit 2018-2023. Ajo është në përputhje me misionin dhe vizionin e tij.</p> <p>Programi mësimor dhe planet e aktiviteteve kërkimore i shërbejnë ndërthurjes së subjekteve teorike me zhvillimet aktuale mediatike në vend.</p> <p>Në objektivat strategjike të institucionit synohet sigurimi i një arsimi</p>




	<p>cilësor e cila si në procesin mësimdhënies ashtu edhe në atë të vlerësimit ti aftësojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për ti përgatitur për sfidat e së ardhmes.</p> <p>Kjo është e shoqëruar edhe me objektivin tjetër strategjik që ka KUB për 5-vjeçarin e ardhshëm që është sigurimi i një cilësie arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Objektivat e Programit Programi Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” janë në përputhje me misionin e KUB dhe plotësojnë standartet.</p> <p>Programi u jep studentëve një përgatitje shkencore në Shkenca Komunikimi, Gazetari, Komunikim, Marrëdhënie Publike, duke ofruar mundësinë që studentët të pajisen me njohuritë për të bërë një analizë të thelluar e shkencore të fakteve dhe situatave të ndryshme, në përfitimin nga studentët të një kulture të gjerë pluraliste, bashkëkohore mbi mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave dhe ngjarjeve.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të mirëformatuar dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të KUB, si dhe me kërkesat e tregut të punës për specialistë në këtë fushë. Programi është ndërtuar dhe përmirësohet vazhdimisht në përputhje me misionin e Institucionit dhe objektivat kryesore të tij. Objektivat e programit përcaktohen qartë dhe përfshijnë dijet teorike, aftësitë dhe kompetencat praktike profesionale në realizimin e punës së specialistit të marrëdhënies me publikun.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit përgjegjës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Humane në Kolegjin Universitar BEDER ka në përbërjen e tij këto departamente:

- (i) Departamenti i Shkencave të Komunikimit
- (ii) Departamenti i Shkencave Islame;
- (iii) Departamenti i Drejtësisë;

Secili nga departamentet ka stafin e tij akademik, një punonjës të personelit ndihmës akademik dhe një kordinatorë të departamentit. Tabelat e plota gjenden në anekset në fund të këtij raporti (Tabelat 2 dhe 3)

Dekanati i Fakultetit të Shkencave Humane të KUB është organi i lartë ekzekutiv dhe ka në përbërje (i) Dekanin; (ii) Zëvendësdekanin; (iii) Përgjegjësit e njësisive bazë (departamenteve); (iv) administratorin e fakultetit (Tabela 1);

Edhe Dekanati i Fakultetit vepron mbi bazën e rregulloreve të përcaktuara dhe të miratuara. Dekanati mblidhet jo më pak se një herë në muaj. Dekani ka titullin Profesor dhe ka një listë funksionesh / detyrash të përcaktuara.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka programe studimi të nivelit të parë dhe të dytë:

- Cikli i Parë i Studimeve: Bachelor në shkenca Komunikimi
- Cikli i Dytë i Studimeve: Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike”

Secili nga Departamentet ka një mision të përcaktuar dhe rregulloret përkatëse. Fakulteti ka rregullore të mirëpërcaktuar për funksionet e tij duke patur të veçantë si “Rregulloren mbi organizimin akademik” ashtu edhe “Rregulloren mbi organizimin administrativ”

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Në rregulloren e organizmit të fakultetit janë dhënë të përcaktuara detyrat dhe funksionet e dekanatit, mbledhjet dhe vendimmarrjet e tyre. Po kështu janë të përcaktuara edhe funksionet e Dekanit, zgjedhja mandati, emërimi dhe rastet e shkarkimit. Fakulteti ka edhe një Administrator, veprimtaria e të cilit po ashtu është e përcaktuar në Rregulloren e organizmit Akademik.

Rregullorja mbi Organizimin Akademik në KUB ka të përcaktuar edhe funksionin e Përgjegjësit të Departamentit dhe Këshillit të Departamentit. Gjithashtu jepen të saktësuar në rregullore edhe Roli i koordinatorit të Departamentit.

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabelat 2 ne aneks)

Personeli akademik, si ai efektiv ashtu edhe ai me kontratë kanë pak a shumë raporte të ngjashme midis departamenteve të ndryshme në Fakultetin e Shkencave Humane (Sikurse shihet edhe nga tabelat 2 (2.1-2.5). Ndër vite numri i PAE për të tre departament ka qenë i ngjashëm me diferenca fare të vogla. Dhe këto raporte kanë mbetur të tilla përgjatë gjashtë viteve. Diferenca midis departamenteve është në numrin e PAK. Departamenti i Drejtësisë ka përgjithësisht numër më të madh pedagogësh me kontratë. Kjo shpjegohet edhe me faktin se disa nga këta pedagogë japin lëndë specifike edhe në programet mësimore të Departamentit të Shkencave të komunikimit. Po kështu në mënyrë proporcionale është edhe raporti i titujve shkencorë dhe gradave midis 3 departamenteve të Fakultetit.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>KUB është organizuar në përputhje me legjislacionin aktual dhe në përmbushje të misionit të tij. Ai ka dy fakultete dhe departamente në përbërje të tij. Institucioni ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakulteti i Shkencave Humane; dhe - Fakulteti i Filologjisë dhe i Edukimit. <p>Secili nga fakultetet më sipër ka tre njësi përbërëse/ departamente.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Shkencave Islame; ▪ Departamenti i Drejtësisë; ▪ Departamenti i Shkencave të Komunikimit. <p>Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; ▪ Departamenti i Shkencave Kompjuterike; ▪ Departamenti i Shkencave të Edukimit.

	<p>Secili nga Departamentet ka një mision të përcaktuar dhe rregulloret e tyre janë të miratuara. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka të mirëpërcaktuar funksionet e tij.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka në përbërje të tij 16 anëtarë. Përgjegjësi i departamentit ka gradën Dr. Ka një pedagog me gradën Prof. Asoc. Dr. Ndërkohë që ka 3 të tjerë me gradën “Doktor” dhe 2 në proces doktorimi.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimeve.</p> <p>Përgjegjësia e departamentit është e përcaktuar në statutin e KUB dhe rregulloren organizmit akademik/të brendshme të departamentit.</p> <p>Departamenti realizon mbledhje periodike për të diskutuar mbi ecurinë e programeve mësimore dhe ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit mësimor. Departamenti si njësi bazë diskuton dhe miraton syllabuset mësimore, diskuton tekstet mësimore dhe literaturën që shoqëron lëndët, bën kërkimin për të gjetur librat më të fundit për lëndët respektive.</p> <p>Drejtuksi i departamentit në bashkëpunim me secilin pedagog në mënyrë individuale shqyrton edhe raportet e vlerësimeve dhe anketimeve që bëhen me studentët për performancën e pedagogeve sipas lëndëve mësimore.</p> <p>Bazuar në natyrën e programit mësimor dhe lëndëve të reja apo ndryshimeve që mund të bëhen në programin e secilit cikël studimi, drejtuksi i departamentit është propozuesi i personelit të ri akademik. Përgjegjësi i Departamentit është i përfshirë në procesin e rekrutimit të personelit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>KUB, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, në profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” është ndërtuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme të KUB, duke plotësuar standardet. KUB përmbush kriterin e 2 fakulteteve dhe 3 njësive respektive për fakultetet.</p> <p>Departamenti ka përgjegjësinë e realizimit të programit dhe cilësisë së tij, duke u kujdesur dhe marrë edhe vlerësimet e anketimeve të realizuara me studentët. Përgjegjësi i departamentit propozon edhe rekrutimin e personelit të ri në përputhje me nevojat që kanë programet e studimit.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës




Personeli akademik dhe ai administrativ i rregullon marrëdhëniet e marrëdhëniet e punës mbi kontrata si me Kohë të Plotë dhe me Kohë të Pjesshme, me afat apo pa afat, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Kodit të Punës si edhe rregulloreve të KUB. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore në KUB u shikuan me metodën e sondimit kontratat e stafit akademik dhe mbështetës. Kontrata e punës kishte edhe një aneks të kontratës në të cilin përcaktoheshin specifikimet e pozicionit të punës. Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB kishte dosjet me kontratat dhe elementët e tjerë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për secilin nga anëtarët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Kontratat kishin të detajuar si pjesën mësimore, ashtu edhe elementët e tjerë të punës që konvertoheshin si elementë të pagës dhe ngarkesës së punës.

Përfshirja e pedagogëve si efektiv me kontratë të plotë apo të pjesshme, ndiqte një proces të përcaktuar rekrutimi, ku shikoheshin të gjithë elementët, si gradat shkencore, diplomat, aktiviteti kërkimor, përvoja dhe kriteret e tjera të përcaktuara me ligj. Kriteret dhe hapja e vendeve të reja të punës publikohej edhe në faqen online të KUB. Departamenti ishte i përfshirë në procesin e rekrutimit, nëpërmjet kërkesës për personel pranë zyrës së Dekanit.

- Për vitin akademik 2013-2014, në programin Msc në Shkenca Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është 9 studentë/ 10 pedagogë, pra afersisht 1 / 1
- Për vitin akademik 2014-2015, në Departamentin e Shkencave Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është: 30 studentë/ 8 pedagogë, pra afersisht 4 / 1
- Për vitin akademik 2015-2016, në programin Msc në Shkenca Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është: 9 studentë/ 7 pedagogë, pra afersisht 1 / 1
- Për vitin akademik 2016-2017, në programin Msc në Shkenca Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është: 15 studentë/ 8 pedagogë, pra afersisht 2 / 1
- Për vitin akademik 2017-2018, në programin Msc në Shkenca Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është: 33 studentë/ 7 pedagogë, pra afersisht 5 / 1
- Për vitin akademik 2018-2019, në programin Msc në Shkenca Komunikimi, raporti studentë/pedagogë është: 17 studentë/ 6 pedagogë, pra afersisht 3 / 1

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 5 ne aneks)

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe nga vizita në institucion numri i personelit akademik me tituj dhe grada përputhet me rregulloret e programit dhe të Kolegjit Universitar BEDER.

Nga viti në vit, ka ardhur duke u rritur numri i PAE në raport me PAK, si numër fizik. Raporti i personelit akademik të angazhuat për këtë program studimi (PAE/PAK) në total, për 6 vitet mësimore të marra në shqyrtim duke nisur nga 2013-2014 deri në vitin aktual është:

- 2/8 (ose 20% PAE/80% PAK), për vitin akademik 2013-2014
- 4/4 (ose 50% PAE / 50% PAK), për vitin akademik 2014-2015
- 3/4 (ose 43% PAE / 57% PAK), për vitin akademik 2015-2016
- 5/3 (ose 63 % PAE / 37% PAK), për vitin akademik 2016-2017
- 4/3 (ose 57% PAE /43 % PAK), për vitin akademik 2017-2018
- 4/2 (ose 67 % PAE / 33% PAK), për vitin akademik 2018-2019

Raportet shprehin edhe ritmin e rritur të marrjes së titujve dhe ofrimit të gradave për personelin akademik efektiv.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Tabela 4 ne aneks)

Departamenti ka Këshillin e Departamentit i cili kryesohet nga përgjegjësi i departamentit dhe përbëhet nga zëvendësit e tij, nëse ka, dhe nga anëtarët e personelit akademik të departamentit. Ky Këshill mbledhet periodikisht me tematika të caktuara. Detyrat e tij janë:

- Nxiti, bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare, në dispozicion të departamentit;
- Shqyrton programet mësimore, bën ndryshimet e nevojshme dhe i propozon Dekanatit të Fakultetit ndryshimet përkatëse;
- I propozon Dekanatit të Fakultetit tekstet mësimore në përdorim të studentëve;
- Realizon programin mësimor sipas planit të miratuar dhe kontrollon cilësinë e mësimdhënies;
- Përcakton tematikën e punës shkencore dhe kontrollon realizimin e saj;
- Monitoron realizimin e kualifikimit shkencor pasuniversitar afatshkurtër dhe afatgjatë të stafit akademik;
- Merr vendime në lidhje me transferimet e studimeve dhe bën njohjen e lëndëve dhe programeve mësimore dhe ia dërgon Fakultetit për dijeni.

Koordinatori i Departamentit është funksion ndihmës akademik me karakter administrativ. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të realizimit të veprimtarisë së departamentit.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 5 ne aneks)

Në tabelën 5 gjendet të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet mes tyre. Kolegjit Universitar BEDER bën përpjekje për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Kjo shikohet edhe nga mbledhjet që bëhen si edhe lista e përditësuar e trajnimeve të organizuara në 2014-2018. (Sipas dokumenteve të vlerësimit të brendshëm dhe tabela 22 në ankese për projektet e veçanta kërkimore sipas anëtareve të stafit).

Në se në fillim të programit, vitit shkollor 2013-2014 raporti PAE/PAK ishte mjaft në disfavor të PAE për secilën nga titujt, por kjo situatë ka ardhur në përmirësim duke i rritur këto raporte në favor të PAE.

Të dhënat sipas gjinisë. Të dhëna sipas moshës (Tabelat 7 ne aneks)

Departamenti i Shkencave të Komunikimit është i balancuar nga kriteri i gjinisë dhe nga viti në vit ka ardhur duke u rritur numri i pedagoqeve femra në departament. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka krijuar një bashkërendim të brezave të ndryshëm gjatë procesit mësimdhënës. Kjo i jep mundësi studentëve të marrin përvojave të ndryshme në lëndë dhe praktika të ndryshme. Janë 6 pedagogë që i përkasin grup moshës 25-35 vjeç, 11 pedagogë të grup moshës 36 - 45 vjeç, 5 pedagogë që i përkasin grup moshës 46 - 55 vjeç, dhe 1 pedagog i grup moshës 66 - 68 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Zyra e Burimeve Njerëzore ka kontratat individuale të secilit nga anëtarët e stafit. Ata janë të njohur me detyrat dhe të drejtat e tyre sipas kontratave respektive. Kontratat janë të firmosura. Me zgjedhje, GVJ shikoi disa kontrata të stafit akademik dhe mbështetës në Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Kontratat e punës janë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontratës i bashkëlidhet një aneks kontratë në

të cilën përcaktohet vendi i punës, pozicioni, të drejtat dhe detyrat e punëmarrësit. Këto të drejta dhe detyrime i bëhen të ditura stafit në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe aneksit të saj.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si pjesë e strukturës organizative të Kolegjit Universitar BEDER, KUB, ka personelin akademik që kryen procesin e mësimdhënies së bashku me veprimtaritë e lidhura me të, personelin administrativ dhe ndihmës.

Personeli administrativ dhe mbështetës, është një pjesë i përbashkët për të gjithë Kolegjin KUB dhe ndërsa sekretare/koordinatore dhe një person tjetër janë të dedikuar në departament. Personeli që është për të gjithë universitetin përfshin zyra të tilla si Burimet Njerëzore, Sekretaria, Biblioteka, zyra e Financës etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ i Institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programit të studimeve dhe për arritjen e tyre. Personeli akademik si PAE ashtu edhe PAK ka përputhje midis kualifikimeve të tyre dhe subjekteve dhe programit mësimor ku është i angazhuar. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka bashkëpunim dhe koordinim mes stafit akademik dhe atij administrativ, duke punuar ngushtësisht për realizimin e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>Personeli akademik dhe administrativ i Institucionit angazhohen në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2018-2023.</p> <p>Objektivat dhe strategjitë e Zhvillimit i bëhen të ditur personelit si nëpërmjet Departamentit ashtu edhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>PAE dhe PAK është faktori kryesor në hartimin e syllabusit. Këshilli i Departamentit dhe Drejtuesi i Departamentit luan rol në përcaktimin e kurikulës dhe organizimin e programeve të studimeve.</p> <p>Departamenti organizon workshope me synim rishikimin përditësimin e kurikulës. Anëtarët e departamentit japin kontributin e tyre mbi ndryshimet në kurikul dhe literaturën përkatëse të lëndëve. Ky workshop organizohet me fillim të vitit akademik dhe diskutimet janë si për literaturën edhe për tematika të veçanta.</p> <p>Ngarkesa mësimore e stafit akademik në KUB përcaktohet në përputhje me kontratat e punës dhe Udhëzimit mbi ngarkesën mësimore. Kjo ndarje e ngarkesës mësimore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Përcaktimi i ngarkesës mësimore mban parasysh edhe profilin dhe eksperiencën e secilit nga anëtarët e stafit.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si pjesë e KUB, ndjek procedura dhe aktet ligjore në rekrutimin e personelit në përputhje me (i) Statutin e KUB, (ii) Rregulloren themelore të KUB; (iii) Procedurën e punësimit të personelit. Procesi përzgjedhës për rekrutimin e personeli përfshin aplikimin individual për pozicionet e njoftuara dhe konkursin përzgjedhës.</p> <p>Sipas statutit të KUB kriteret profesionale të punësimit përcaktohen nga njësia bazë, në këtë rast departamenti. Këto aprovohen nga Dekani dhe Rektori i KUB. Për përzgjedhjen e kandidatëve që do të jenë pedagogë ngrihet një komision i posaçëm me përbërje shumica nga departamenti i cili bën propozimet dhe listimin e aplikantëve të cilin ja përcjell Rektorit për vendimmarrje.</p> <p>Pedagogët që japin mësim në programin Master i Shkencave, profilet “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike” në departament janë të punësuar me kontratë si Personel Akademik Efektiv në KUB (PAE) dhe si Personel Akademik me Kontratë.</p> <p>Duke krahasuar ngarkesën mësimore për lëndët e mbuluara nga PAE ndaj PAK të angazhuar në realizimin e programit (bazuar në Tabelen 16, për vitet 2013-2019, respektivisht ngarkesa mësimore rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin 2013-2014 67% PAE dhe 37% PAK - Për vitin 2014-2015 80% PAE dhe 20% PAK - Për vitin 2015-2016 80% PAE dhe 20% PAK - Për vitin 2016-2017 90% PAE dhe 10% PAK - Për vitin 2017-2018 90% PAE dhe 10% PAK - Për vitin 2018-2019 93% PAE dhe 7% PAK <p>Personeli Akademik Efektiv (si numër fizik personeli) në programin e studimit ka ardhur duke u rritur dhe duke marrë më shumë ngarkesë mësimore nga viti në vit (20%; 50%; 42%; 63%; 57%; 67%)</p> <p>Vlerësimi i pedagogëve kryhet në disa nivele: nga drejtuesi i drejtpërdrejtë në këtë rast ai i Departamenti të Shkencave të Komunikimit; Në fund të çdo semestri gjatë vitit akademik bëhet vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësimet janë individuale dhe pedagogët njohin vetëm vlerësimet e tyre dhe jo të pedagogëve të tjerë duke ruajtur kështu të drejtën e privatësisë.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mban bazën e të dhënave të raporteve të vlerësimit, rekrutimit të personelit, intervistat e kandidatëve, njoftimeve për vende vakante, etj. Njoftimet janë të postuara edhe në faqen ueb të institucionit.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit ka gradën Dr. dhe ka një eksperiencë të akademike dhe profesionale të spikatur në fushën e komunikimit dhe të medias. Ai është autoriteti më i lartë drejtues për njësinë bazë mësimore kërkimore. Ky kriter është i sanksionuar edhe në Statutin</p>

<p>studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>e KUB.</p> <p>Sikurse shihet edhe nga syllabuset e lëndëve, titullari i çdo lënde në programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profili <i>Gazetari</i> dhe profili <i>Marrëdhënie publike</i>, mban të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>KUB nuk ka program në Master Profesional në shkenca komunikimi.</p> <p>Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në KUB. Kjo shihet nga kontratat e punës së titullarëve të fakultetit dhe Departamentit dhe gjithë zyrtarëve të tjerë, edhe në Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Programi “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profilet <i>Gazetari</i> dhe <i>Marrëdhënie publike</i>, në kurrikulën e tij nuk parashikon praktikë profesionale.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga verifikimi gjatë vizitës në institucion dhe nga RVB rezulton se studentët që ndjekin programin e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profilet <i>Gazetari</i> dhe <i>Marrëdhënie publike</i> kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës. Kjo është e përcaktuar edhe në rregulloren e këtij cikli studimi. Udhëheqësi orienton dhe mbikëqyr përkrah studentët në punën kërkimore dhe tezën dhe përgatitjen dhe raportimet në seancat metodologjike që ata bëjnë në departament dhe Fakultet.</p> <p>Udhëheqësi i tezës ka patur gradën shkencore “Doktor”. Kjo u vërtetua me dokumentacionin e marrë gjatë vizitës dhe nga RVB. Ky kriter është i plotësuar dhe i sanksionuar edhe në rregullore.</p> <p>Sipas rregullores së studimeve të ciklit të dytë në Master i shkencave në shkenca komunikimi, profilet <i>Gazetari</i> dhe <i>Marrëdhënie publike</i>, në nenin 16 të saj, në përputhje me kërkesat e këtij kriteri shprehet qartë: “Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi, është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të përparuar teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.”</p> <p>Nga kqyrja e informacionit në vite rezulton që një lektor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit i angazhuar në programin e studimit “Master i shkencave”, nuk ka udhëhequr më shumë se 5 studentë në hartimin e tezës.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	

<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Gjatë vizitës në KUB dhe takimet në Departament Grupi një dosje e plote e praktikës së ndjekur që nga fillimi i kërkesës për përzgjedhjen e temës së punimit për Mastër. Studentët e programit “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike, e fillojnë procedurën me plotësimin e një formulari të posaçëm ku shënohet titulli i propozuar i tezës dhe udhëheqësi i propozuar. Formularët i paraqiten Dekanatit, i cili vlerëson çdo titull të propozuar nga studentët. Departamenti pasi ka marrë preferencat e studentëve bën një rishpërndarje të udhëheqësve, duke patur parasysh fushën e tyre të specializimit.</p> <p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Gjatë përcaktimit të udhëheqësve të temave të studentëve “Master” dhe përcaktimit të ngarkesës mësimore, i kushtohet rëndësi njohurive teorike të secilit nga anëtarët e personalit akademik që do të marrë këtë detyrë. Departamenti sigurohet që udhëheqësi të ketë njohuri të përparuar teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p> <p>Të dy kriteret më sipër janë të plotësuar dhe sanksionohen edhe në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë në “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike.</p>
---	---

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike nuk ka të parashikuar në planin mësimor orë laboratorike.</p> <p>Departamenti ka Këshilltar Akademik, Koordinatore dhe personel ndihmës akademik të cilët koordinojnë punët për ndjekjen e mbarëvajtjes së procesit të mësimor.</p> <p>Departamenti si pjesë përbërëse e KUB i përdorë pedagogët dhe stafin e angazhuar në mënyrë optimale sipas ngarkesës mësimore dhe objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Ndërkohë, për plotësimin e lëndëve me karakter specifik, janë angazhuar anëtarë të stafit akademik me kontratë me tituj shkencorë e të specializuar në fushat respektive.</p>
--	--

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga diskutimet në Departament dhe tek zyra e Burimeve Njerëzore, si edhe nga kontratat e punës për secilin nga pedagogët është e përcaktuar ngarkesa mësimore. Kjo ngarkesë përveçse në kontratat e punës dhe në anekset individuale të kontratave të punës, është e përcaktuar qartësisht edhe në udhëzimit mbi ngarkesën mësimore.</p> <p>Ngarkesa mësimore e vlerësohet me orë mësimore. Ngarkesa mësimore, e përcaktuar sipas edhe funksioneve administrative e përcaktuar me rregullore është: rektori 3 (tre) orë mësim në javë, zëvendës rektori 6 (gjashtë) orë mësim në javë, dekani 6 (gjashtë)</p>
--	--

	<p>orë mësim në javë, përgjegjësi i Departamentit 10 (dhjetë) orë mësim në javë, stafi me tituj Prof. Dr. 12 (dymbëdhjetë) orë mësim në javë mësim në javë, stafi me tituj Prof. Asoc. 14 (katëmbëdhjetë) orë, Doc./Dr. 16 (gjashtëmbëdhjetë) orë mësim në javë, lektorët 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësim në javë, instruktorët 20 (njëzet) orë mësim në javë.</p> <p>Ngarkesë mësimore parashikon që pedagogët dhe stafi të kenë edhe kohë për angazhimin administrativ dhe kërkimin shkencor respektivisht sipas pozicioneve.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e BNJ e KUB arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga zyra e punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar dhe të përditësuara. Kjo procedure ndiqet si për personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, PAE dhe PAK.</p> <p>Zyra e BNJ në KUB përgatit listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrative.</p> <p>Në fund të çdo viti bëhet edhe mbledhja e të gjithë angazhimit kërkimor-shkencor për secilin, i pasqyruar ky edhe në raportin vjetor të aktiviteteve.</p> <p>Kriteret e rekrutimit përcaktohen nga bashkëpunim i Departamentit përkatës që ka nevojë për personel akademik dhe Dekani i fakultetit i cili i miraton ato. Kjo bëhet në bashkëpunim me Zyrën e BNJ. Më pas ato shpallen nga faqen e ueb të KUB sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Procedura parashikohet edhe në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë në “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike, ku thuhet se “Vlerësimi i titujve të stafit akademik është kompetencë e departamentit të Shkencave të Komunikimit dhe bëhet me procedura publike.”</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Kriteret e vendosura për personelin akademik dhe ndihmës për programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike plotësohen.</p> <p>Programi “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike, ka të garantuar si në praktikë ashtu edhe të përcaktuar në rregullore përfshirjen e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p> <p>Programi plotëson maksimalisht kriteret për përfshirjen dhe rolin e personelit akademik në hartimin dhe ndryshimet në kurrikulat.</p> <p>Personeli që udhëheq temat e diplomimit zbaton kriteret dhe i përshtatet specifikës së fushës së temës që udhëheqin me profilin dhe eksperiencën e tyre profesionale.</p> <p>KUB ka një politikë të qartë të vlerësimit të stafit akademik. Personeli akademik i angazhuar në program ka përgatitjen dhe formimin e duhur për të përmbushur objektivat e programit.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenca.

Kolegji Universitar BEDER kryen veprimtaritë e tij në dy godina A dhe B. Të dyja godinat janë të marra me qira me një sipërfaqe totale 5628 m².

Godina A, është një godinë me tetë 8 kate dhe sipërfaqe 3957 m². Në godinën A ka si klasa mësimore ashtu edhe zyra administrative për fakultetet e departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në godinën A është e vendosur edhe Biblioteka e Universitetit dhe Muzeu i Medias.

Godina B, është një godinë me dy kate dhe sipërfaqe 1671 m². Në godinën B zhvillohen mësim nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

Godinat ofrojnë si pajisje teknike ashtu edhe komoditet për studentët dhe pedagoget. Sallat e mëcimit kanë kondicionerë. Në mjaft nga klasat ka "smart tabela" që krijojnë mundësi për interaktivitet në mësimdhënie. Gjithashtu ka edhe videoprojektorë.

Biblioteka, Muzeu, Laboratori i Informatikës: Biblioteka ka një klasifikim të librave sipas Bibliotekës së Kongresit. Ajo ofron libra për studentët si në gjuhën shqip ashtu edhe në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht e turqisht. Ndërkohë në bibliotekë funksionon edhe një kompjuter i sistemit të kërkimit online, ku studentet mund të download libra të ndryshëm.

Nga vizita në Bibliotekën u informuam se shtimi me tituj të rinj të fondit bëhet përmes:

- Blerjeve të teksteve universitare dhe librave të reja, që janë pjesë e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar;
- Porositë dhe blerjet online për botime periodike shkencore, etj.
- Dhurimi që bëjnë organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione.

Muzeu i medias ka disa pajisje të përdorura ndër vite që në fillesat e transmetimeve radio dhe televizive në vend, si kamera, pajisje riprodhuese, radio, pulte transmetimi, etj. Pajisjet janë mjaft interesante për të krijuar idenë e zhvillimeve historike të medias.

Një sallë e madhe seminaresh me kapacitet mbi 200 persona ndodhet në katin e parë pranë muzeut e cilat përdoret për konferenca.

Aktivitetet extra kurikulare: Në godinën B, krahas klasave dhe zyrave, ka edhe ambiente për veprimtari ekstra-kurikulare. Aty ndodhet palestra, që studentët dhe personeli mund ta shfrytëzojnë për aktivitete individuale sportive.

Godinat e mësipërme janë të pajisura me mjetet për mbrojtjen kundër zjarrit, si edhe shkallët e emergjencës si dhe e pajisur me sistem ngrohje. KUB ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogjenerator), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji).

Sipas numrit aktual të studentëve në KUB institucioni ofron rreth 8.1 m²/student.

KUB ka ambiente hidrosanitare në çdo kat, rreth 47 bokse hidro-sanitare për studentët dhe personelin. Godina e KUB me arkitekturën e saj ofron mundësinë e ndriçimit natyral.

Gjatë bashkëbisedimit me studentët e këtij programi studimi ata shprehën mendimin dhe për rritjen e hapësirave sociale për shoqërim të tyre gjatë dhe pas orareve zyrtare të mësimin, si mjedis ku do të mundësohej infrastukturë në shërbim të nxitjes së shkëmbimit dhe prezantimit të ideve, pikëpamjeve dhe iniciativave të

ndryshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

KUB ka një infrastrukturë të organizuar mirë dhe me mjaft mjedise të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij dhe arritjen e synimeve të programit të studimit. Si nga dosja e vlerësimit të brendshëm ashtu edhe nga vëzhgimet në institucion, u vu re një mjedis cilësor dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit. Sallat e leksioneve dhe sallat e seminareve përbushin nevojat e studentëve dhe pedagogëve në KUB dhe specifikisht në Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Gjithashtu në shërbim të studentëve janë edhe ambiente të pajisura me Internet dhe shërbime mbështetëse si fotokopja, salla e bibliotekës etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>KUB ka një mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Kjo shihet edhe planimetrinë e objektit.</p> <p>KUB ka një kontratë afatgjatë qiraje në përdorim hapësirën aktuale. KUB planifikon ndërtimin e një kampusi universitar të ri (Projekti i këtij kampusi është në dosjen e vlerësimit të Brendshëm).</p> <p>Programet aktuale të studimit ofrohen në një godinë të vetme.</p> <p>KUB nuk ofron programe studimi të përmendura në këtë kriter.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe oashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e KUB zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të programit të studimit të gazetarisë. Ajo është e hapur për studentët gjatë gjithë javës dhe ka një total prej rreth 36,000 tituj. Në biblioteka ka si librat e përzgjedhur dhe të klasifikuar, ashtu edhe botime periodike, të vendit dhe të huaja.</p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë si nëpërmjet blerjes, ashtu edhe nismave dhe projekteve studentore. Një donacion i Ambasadës Amerikane ka sjellë mbi 300 libra në bibliotekë dhe më tepër se 200 prej tyre kanë qenë të dedikuara për studentët e gazetarisë.</p> <p>Koleji Universitar BEDER parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor dhe kjo behët në përputhje me kërkesat e çdo departamenti specifik sipas programeve të studimit.</p> <p>Oraret e bibliotekës janë të njoftuara në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Gjatë sezonit të provimeve biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë.</p> <p>Biblioteka e KUB ka edhe sistemin elektronik të marrjes së literaturës të nevojshme për studentët duke e kthyer atë në format të editueshëm duke lehtësuar punën e studenteve.</p>

	Biblioteka e KUB ka një abonim në bibliotekën online Ebsco Host ku studentët kanë akses për rreth 45,000 libra dhe 5000 revista. Gjithashtu biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>KUB ka mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë Qendra e medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterëve, etj. (Këtu janë listuar vetëm ato që lidhen me Departamentin e Komunikimit). Kjo paraqitet edhe në numrat e klasave të detajuara më lart.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me tabela interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore, janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.</p> <p>Në ambientet e dedikuara për lëndët e gazetarisë ka laboratorë funksionale të përshtatshëm për programin e studimit të gazetarisë. (Laboratori i Gjuhëve të Huaja, Qendra e Medias dhe e Komunikimit, laboratorit i informatikës, redaksia e informacionit e portali informativ www.objektiv.al)</p> <p>Institucioni ka pajisje me programe të nevojshme për programin e studimit dhe editimit sipas kërkesave profesionale dhe praktike të studentëve të gazetarisë.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme mediatike, ku studentët zhvillojnë këto praktika. Por praktikat profesionale ofron edhe brenda KUB, siç është Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, revista Objektiv dhe portali www.objektiv.al</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Duke shikuar kërkesat dhe plotësimin e tyre për infrastrukturën dhe logjistikën e KUB në realizimin e programit të studimit, vlerësohet se përmbushen standardet.</p> <p>KUB garanton infrastrukturën e logjistikën, ka një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme, me mjedis qendror dhe administrativ dhe mjedise ku zhvillohet veprimtaria studimore dhe shkencore.</p> <p>KUB ofron për studentët bibliotekën me literaturë të mjaft fushave të studimit, e cila pasurohet vazhdimisht me tituj të rinj shkencorë në përputhje me disiplinat mësimore. Ky pasurim realizohet si me projekte të studentëve dhe të personelit akademik si edhe me donacione nga donatorë të huaj. Biblioteka ofron dhe shërbimin online dhe ka mundësinë komunikimit në Book Academic Collection.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Duke qenë një IAL privat dhe jo fitimprurës, KUB, pjesën më të madhe të të ardhurave në buxhetin e vet e krijon nga pagesat që vijnë nga studentët që ndjekin studimet, si dhe nga donacionet. Këto të fundit bëhen pjesë e buxhetit bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Zë të ardhurash janë dhe konsulencat dhe shërbimet që KUB kryen për të tretët.

KUB procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashkuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit në këtë program studimi (në përqindje) jepen në Tabelën 9.1. Nga kjo Tabele si viti më i plotë është viti akademik 2016-2017, ku:

• Grantet për kërkim	1.1 %
• Konsulencat, shërbimet	0.1 %
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	70 %
• Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	28.9 %

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje) në 6 vitet e fundit në këtë program studimi jepen në Tabelën 9.2. Për vitin akademik 2016-2017, rezulton:

• Shpenzimet për Paga dhe sigurime	66.2 %
• Shpenzimet operative	33.8 %

Grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës në institucion u njoh dhe me dokumentacionin mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, duke evidentuar se të dhënat që paraqiten në materialin e ekspertëve të brendshëm përputhen, si për treguesit e të ardhurave dhe financimeve të ndryshme në 6 vitet e fundit, ashtu dhe për shpenzimet po në këtë periudhë.

Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

KUB me statusin e një IAL-je jofitimprurëse procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashkuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri I Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	KUB realizon auditime të brendshme dhe të jashtme për vlerësimin e situatës financiare dhe menaxhimi financiar është nën kontrollin e Fondacionit "Hafiz Ali Korça", pjesë e të cilit është Kolegji. Raportet financiare hartohen bazuar në legjislacionin në fuqi, duke respektuar

<p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>afatet, dhe duke pasqyruar në detaje të ardhurat dhe shpenzimet që kryen.</p> <p>Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me raportime të natyrës financiare, si dhe të auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Aty janë përfshirë pjesa e të ardhurave, sic janë ato nga tarifatat e studimit të studentëve, nga donacionet vendase apo të huaja, të ardhura nga pjesëmarrja në projekte të ndryshme a si konsulenca etj. Gjithashtu përfshihen dhe pjesa e shpenzimeve të realizuara për funksionalitetin e KUB, apo dhe zëri i buxhetit për bursat e akorduara si mbështetje për studentë të ndryshëm.</p>
--	--

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Në mënyrë të përvitshme KUB harton raportin financiar nga një kontabilist i miratuar, dokument që përfshin zërat e të ardhurave, duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi për nivelin e parë, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit, nga konsulenca të ndryshme etj. Gjithashtu dokumenti përmban të detajuar dhe zërat e shpenzimeve që kryen, si ato në formën e pagave dhe honorareve për mësimdhënien, apo dhe shpenzime të tjera administrative e operative në funksionalitetin e të gjithë institucionit.</p> <p>Ky dokument arkivohet pranë fondacionit dhe KUB, sic e përmendëm më sipër, bazohet në procesin e raportimit financiar tek kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.</p> <p>KUB respekton dhe afatin e raportimit për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke e kryer cdo fundviti. Pjesë e këtij raportimi është dhe buxheti për vitin që ka kaluar, projektsioni për buxhetin e vitit të ri, si dhe projektbuxheti afatmesëm.</p> <p>Gjatë njohjes së dokumentacionit mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit grupi i ekspertëve të jashtëm vërejti qëndrueshmëri në realizimin e këtij programi studimi, duke krijuar mendimin se KUB ka kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur këtë trend edhe për kohën vijuese, në favor të përmirësimit të situatës financiare në institucion dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i ekspertëve të jashtëm evidentoi se KUB vit për vit harton raportin financiar nga një kontabilist i miratuar. Ky dokument që përfshin zërat e të ardhurave, duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi për nivelin e parë, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit, nga konsulenca të ndryshme etj.

Dokumenti që arkivohet pranë fondacionit, pjesë e të cilit është KUB, bazohet në procesin e raportimit financiar tek kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për

organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Gjatë njohjes së dokumentacionit mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit ekipi i ekspertëve të jashtëm vërejti qëndrueshmëri në realizimin e këtij programi studimi, duke krijuar mendimin se KUB ka kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur këtë trend edhe për kohën vijuese, në favor të përmirësimit të situatës financiare në institucion dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësia së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

KUB ka ndërtuar një sistem brenda institucionit që ndjek dhe ka përgjegjësinë për aspektet e sigurimit të cilësisë në përgatitjen e studentëve, bazuar në standardet dhe kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pjesë e këtij sistemi të brendshëm është dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC, që ka 5 anëtarë, (3 pedagogë të brendshëm, 1 student dhe 1 ekspert i jashtëm). NJSBC ka kompetencë të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik; të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit për të hartuar standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë; të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet; të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse; të hulumtojë në lidhje me modelet e ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre në njësitë e tjera akademike dhe administrative; të njoftojë njësitë për vendimet e marra, të mbikëqyrë zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune; të ndjekë procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit; të ndjekë përgatitjen e terrenit për 'vlerësimin e jashtëm' të KUB dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm.

NJSBC ka në përgjegjësinë e vet dhe organizimin e pyetësorit studentor (në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve), me fokus vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore. Këto vlerësime raporton në Senatit Akademik të KUB.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Bazuar në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe aktet rregullative të miratuara nga MASR dhe vetë institucioni, Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC; Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin; si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

Këto struktura ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafsh të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik, duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.

Në takimin me përfaqësues të njësisë së SBC-së, apo dhe në takimin që grupi ekspertëve të jashtëm zhvilloi me drejtesit e departamentit dhe të stafit akademik u evidentua realizimi i vlerësimit të personelit të angazhuar dy herë brenda vitit akademik, në fund të semestrit dhe në mbyllje të vitit, vlerësim që në 6 vitet e fundit ishte standardizuar, sipas një rregulloreje të posacme. Vlerësimi bëhet në të paktën tre rrafshë: vlerësim i studentëve për personelin, vetëvlerësim për personelin, vlerësim i eprorëve për vartësit etj. Përmes anketimit me studentët mblihdeshin vlerësime të tyre për metodologjinë e mësimdhënies për secilën lëndë, për aspekte të korrektesës së pedagogëve në auditor, për leksionet, seminarët, komunikimin, mbështetjen me konsultime etj. Procesi i marrjes së mendimeve nga studentët e dy profileve të programit të studimit Master për stafin akademik ishte konfidencial (pohuar dhe nga vetë ata në takimin me grupin e ekspertëve të jashtëm), por rezultatet iu shpërndareshin individualisht secilit prej pedagogëve.

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga vetvlerësimi i njësive bazë në KUB, përblidheshin në një raport që i paraqitej rektoratit. Përfaqësues nga NJSBC pohuan dhe aplikimin e një formati tjetër për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe ato administrative, që është organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore janë prezent të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në janar 2010, KUB është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Përveç vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve që përmendëm më sipër, në KUB aktivizohet nga rektorati dhe një komision i brendshëm ad-hoc, i cili auditon njësitë akademike dhe administrative mbi ligjshmërinë e administrimit të dokumentacionit të brendshëm. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me formatin e mënyrës se si realizohet auditimi i brendshëm, përmes evidencës përkatëse, për metodologjinë, synimet dhe ndërhyrjet që realizon komisioni në rastet kur ka mospërputhje të dokumentacionit me dispozitat statutoare dhe të rregulloreve.

Pjesë e vlerësimit të brendshëm janë dhe treguesit e infrastrukturës dhe shërbimeve logjistike. Në KUB ky vlerësim zhvillohet një herë në vit, me synimin e tërheqjes së mendimeve dhe sugjerimeve në favor të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ofrohen për studentët, stafin akademik, si dhe personelin mbështetës.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Përmes anketimit me studentët janë mbledhur vlerësime të tyre për metodologjinë e mësimdhënies për secilën lëndë, për aspekte të korrektesës së pedagogëve në auditor, për leksionet, seminarët, komunikimin, mbështetjen me konsultime etj. Anketimet me studentë zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri.

Nga vetvlerësimi i njësive bazë në KUB, hartohet një raport vjetor që i paraqitet rektoratit. Janë organizuar prezantime të hapura të këtyre raporteve vjetore të vetëvlerësuesve ku janë prezent të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.

KUB realizon dhe kualifikime të personelit në fushën e kërkimit shkencor, trajnime që janë mbështetur nga NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore me synimin e garantimit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Grupi i ekspertëve të jashtëm shqyrtoi dokumenta që lidheshin me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, si dhe përpjekjet e institucionit për përmirësimin e saj në komponentët e zbatimit të kurrikulës dhe kërkimit shkencor.

Për këtë aspekt grupi i njoh me mënyrë e raportimit vjetor në MASR, me formatin e evidencës për mënyrë e realizimit të auditimit të brendshëm, me formatin e anketës që plotësohej dy herë në vit nga studentët (para dhënie së provimeve të sezonit), udhëzimin mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave, përmbajtjen e planit strategjik për periudhën 2018-2023, si dhe të mëparshmin 2012 – 2017, vendimin e senatit të KUB për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme të vlerësimit të brendshëm etj. Ky dokumentacion ndikon pozitivisht në garantimin e cilësisë për njësitë përbërëse të Kolegjit, si dhe në tërësi të institucionit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Për ecurinë e programeve të studimeve, KUB përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese, mes tyre është ngritja dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC. Gjithashtu ekziston dhe një Komision i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Gjatë takimit me përfaqësues të këtyre strukturave, grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me strukturën e tyre, angazhimin, kompetencat, procesin e raportimit etj. Angazhimi i drejtpërdrejtë ishte për zhvillimin dhe monitorimin e anketës me studentët për personelin akademik dhe përmbajtjen e lëndëve.</p> <p>Në vlerësimin e cilësisë së angazhimit të pedagogëve KUB, si për cdo njësi të institucionit dhe për ecurinë në programin Bachelor në shkencat e komunikimit, ndjek mbledhjen e të dhënave nga anketime, të paktën në tre rrafshë: Pedagogët vlerësohen për efektshmërinë e tyre nga studentët; vetvlerësohen; si dhe i nënshtrohen një vlerësimi nga eprori i tyre në Departamentin ku përfshihet dhe programi Master në dy profilet, Gazetari dhe Marrëdhënie Publike.</p> <p>Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve, përmes metodave të tërthorta, si psh zhvillimi i anketave në fund të dy semestrave, material që shërben për të ndjekur konkretisht performancën si dhe për të shikuar nevojat për përmirësime në dobi të mbarëvajtjes e kurrikulës, të marrëdhënieve pedagog – student etj.</p> <p>Interesimi për mendimet dhe gjykimet e studentëve orientohen në aspekte të tilla, si mbi përmbajtjen e lëndës, mbi performancën e pedagogut të lëndës, mbi shërbimin që ofrohen në institucion etj.</p> <p>Por aplikohen dhe metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimet me pikë për pjesën e aktivizimit të tyre në auditor, për realizimin e detyrave të kursit, për praktikën, përfshirjen në projekte, vlerësim për testin pjesor, apo atë përfundimtar etj.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me formatin dhe raste konkrete të vlerësimit që bënin studentët për pedagogun dhe ecurinë e lëndës, që realizohej sistematikisht dy here në një vit akademik, në fund të semestrit të parë (para provimeve), si dhe në fund të vitit (para provimeve të semestrit të dytë).</p> <p>Aktiviteti i këtyre strukturave për sigurimin e cilësisë pasqyrohet dhe në një nënfaqe të vecantë të www.beder.edu.al.</p> <p>Nga kqyrja e www.qac.edu.al u vu re që lënda nuk ishte e aktualizuar në informacionin për dinamikën e angazhimeve dhe kalendarin e veprimtarive të pritshme.</p>
---	---

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>KUB realizon dhe publikon analiza vjetore ku në focus është dinamika e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, përfshirë dhe programin e Masterit i Shkencave në Shkenca Komunikimi me të dy profilet e tij.</p> <p>Pjesë e raporteve vjetore është dhe analiza SËOT, e cila evidenton arritje por dhe problematikat e mundësitë për rritjen e cilësisë së programeve të nivelit të dytë.</p> <p>Gjithashtu, informacionin mbi vetëvlerësimin institucional në shkallë hierarkike, KUB e përfshin në raportet vjetore që paraqet në MASR çdo fundviti akademik.</p> <p>Kolegji kujdeset që rezultatet e vlerësimit në të gjitha rrafshet të publikohen në ëbsite-n zyrtar, si një mundësi e ndjekjes nga grupi i interesit (studentë, pedagogë, punonjës të administratës etj). Gjithashtu KUB ka vendosur në faqen e internetit dhe dokumentet e planit strategjik institucional për periudhën 2012 – 2017, si dhe për 2018 – 2023.</p>
--	--

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Kolegji ka arritur të finalizojë dy akreditime, në vitin 2013 nga APAAL dhe në vitin 2017 nga agjencia britanike, “Quality Assurance Agency” në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Bazuar në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe aktet rregullative të miratuara nga MASR dhe vetë institucioni, Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC; Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin; si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</p> <p>Këto struktura ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafshet të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik,</p>
---	--

	<p>duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.</p> <p>Ideimi, përcaktimi i politikave të zhvillimit të KUB bëhet nga Senati, si organ kolegjal dhe vendimmarrës, drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.</p> <p>Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore përcillen për në Senat duke pasur parasysh parimin hierarkik vertikal: departament - fakultet - rektorat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së menaxhimit të kurrikulave.</p> <p>Rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor shpjegohen dhe nxiten përmes dokumenteve të tilla, si Manuali i Sigurimit të Cilësisë, Guida e Studentëve dhe ajo e personelit, me të cilat u njoh dhe grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës dhe takimeve në Kolegj.</p> <p>Që me miratimin e planit të parë strategjik 5 vjeçar për periudhën 2012 – 2017 është përfshirë dhe pjesa për përmirësimin sistematik të cilësisë. Gjithashtu dhe kjo është pjesë dhe e dokumentit strategjik që është në fuqi, për periudhën 2018 – 2023, fokusuar në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit dhe janë të shkarkuara në website-n e tij.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Bazuar në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe aktet rregullative të miratuara nga MASR dhe vetë institucioni, Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC; Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin; si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.</p> <p>Këto struktura ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafsh të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik, duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.</p> <p>Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve, përmes metodave të terthorta, si psh zhvillimi i anketave në fund të dy semestrave, material që shërben për të ndjekur konkretisht performancën si dhe për të shikuar nevojat për përmirësime në dobi të mbarëvajtjes e kurikulës, të marrëdhënieve pedagog – student etj. Interesimi për mendimet dhe gjykimet e studentëve orientohen në aspekte të tilla, si mbi përmbajtjen e lëndës, mbi performancën e pedagogut të lëndës, mbi shërbimin që ofrohen në institucion etj.</p> <p>Që me miratimin e planit të parë strategjik 5 vjeçar për periudhën 2012 – 2017 është përfshirë dhe pjesa për përmirësimin sistematik të cilësisë. Gjithashtu dhe kjo është pjesë dhe e dokumentit strategjik që është në fuqi, për periudhën 2018 – 2023, fokusuar në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit dhe janë të shkarkuara në website-n e tij.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, ku përfshihet dhe programi i studimit Master i shkencave në Shkencat e Komunikimit me dy profile, ka për mision përgatitjen e studentëve që ndjekin dy vite në kualifikimin e tyre në fushën e gazetarisë dhe marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme e ndërlydhura me to, duke u bazuar vlerat universale, si dhe duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, të përhapjes në shkallë të gjerë internetit dhe mediave të reja.

Ky program studimi synon t'u japë të diplomuarëve njohuritë teorike dhe shprehitë profesionale me trajnimin e thelluar në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe medias, t'u krijojë atyre një vizion të ri për komunikimin në Shqipëri, në përputhje me përvojën e krijuar të plotësuar me konceptet evropiane. Të përpiqet për të realizuar një status të ri të gazetarit në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore që janë krijuar në ditët e sotme. Programi shtron alternativa konkrete për zhvillimin e medias në bazë të strategjisë kombëtare me ndihmesën e vet për krijimin e një elite të re të komunikimit.

Bazuar në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë në KUB, studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, profili *Gazetari* pajisen me diplomë "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, profili: *Gazetari*.

Kurse ata që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, profili *Marrëdhënie publike* pajisen me diplomë "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, profili: *Marrëdhënie publike*.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Ky program është themeluar në vitin akademik 2011-2012, me dy profile: *Gazetari* dhe *Marrëdhënie publike*, ku studentët thellohen me njohuritë e tyre teorike dhe shprehitë praktike në fushën e marrëdhënieve publike dhe të medias me synimet që, të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë; të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në media e në sektorin e marrëdhënieve me publikun; të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e gazetarit për të informuar publikun në tërësi; të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të gazetarisë dhe komunikimit në tërësi; të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.

Synimet kryesore të programit janë: të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë; të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në media e në sektorin e marrëdhënieve me publikun; të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e gazetarit për të informuar publikun në tërësi; të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion; të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës; të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të gazetarisë dhe komunikimit në tërësi; të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Master i shkencave në Shkencë Komunikimi ndiqet nga studentët sipas sistemit me kohë të plotë. Kohëzgjatja e e programit është 2 vjet

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve finale.
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve finale
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.
- 1 orë mësimore = 50 min.

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 11 ne Aneks)

Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, bazuar në planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit, me vendim Këshillit të fakultetit dhe miratur me vendim të Senatit Akademik të KUB.

Plani mësimor që ofron ky program studimi është në favor të thellimit të njohurive dhe shprehive për studentët e ciklit të dytë. Lëndët përbëjnë një fluks tematik që shtyn më tej trajtimet që janë zhvilluar në formë teorike apo praktike profesionale gjatë nivelit të parë Bachelor, duke nxitur tek studentët e përfshirë në program interesin për aspekte të ndryshme në profilin që ata kanë zgjedhur të ndjekin për Masterin. Është i drejtë dhe raporti mes kohës në auditor me kohën për punë të pavarur.

- Ndarja e orëve në auditor për leksionet, seminarët, praktikat lëndore dhe provimin përfundimtar, si dhe orët e pavaruara të studentit janë si më poshtë:

Leksionet	720 orë në auditor	dhe 855 orë punë e pavarur e studentit
Seminarët	240 orë në auditor	dhe 135 orë punë e pavarur e studentit
Praktikat lëndore	0 orë në auditor	dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
Praktikën Profesionale	0 orë në auditor	dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
Provimet përfundimtare	30 orë në auditor	dhe 270 orë punë e pavarur e studentit
Teza	26 orë në auditor	dhe 724 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 15 në Aneks)

Deri më tani nuk ka ndryshime në planin mësimor, që pas asaj që është licencuar dhe është zbatuar në vitin e parë akademik kur ka nisur ky program studimi.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 16 ne Aneks)

Nga shpërndarja e lëndëve për pedagogët që përfshihen në këtë program studimi evidentohet që ata kanë të paktën gradën "Doktor i Shkencave". Nga njëri vit akademik në tjetrin pasardhës shikohet qëndrueshmëri në stafin që angazhohet. Caktimi i lëndëve është në sinkron me specialitetin dhe ekspertizën që pedagogët kanë, si një tregues për garantimin e cilësisë në mësimdhënie, në procesin e kërkimit shkencor dhe praktikës profesionale.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Për vlerësimin e hartimit të syllabus-eve që kanë hartuar anëtarët e stafit akademik të programit Master i shkencave në Shkencat e Komunikimit, për dy profilet, grupi i ekspertëve të jashtëm, shqyrtoi raste konkrete, ku evidentoi se përmbajtja e tyre ishte e standardizuar: duke reflektuar prezantimin e të dhënave kryesore mbi lëndën, si një përmbajtje që qartëson ndjekësin e Programit që në fillim të procesit mësimor mbi komponentët e domosdoshëm që duhen ditur, me synimin e lehtësimit të ndjekjes së saj gjatë zhvillimit në auditor.

Në syllabus-e përfshihen dhe emërtimi i lëndës/modulit; viti/semestri kur zhvillohet lënda; emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës; çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik; ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; format e vlerësimit të studentëve; detyrimet e studentit për lëndën dhe literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Shefi i Departamentit është autoriteti direkt që mbikqyr këtë proces. Në rast të problematikave në hartimin e tyre, shefi ndërhyr në plotësimin rigoroz të tyre, sidomos tek pjesa e aktualizimit të literaturës së detyrueshme dhe asaj ndihmëse.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Përmbajtja e një syllabus-i ka ndryshuar në periudha të ndryshme, që pas vitit të parë akademik të KUB-it, 2011 – 2012, kur dhe është hapur ky program studimi. Në rang institucional, por dhe njësie bazë, janë organizuar dhe workshop-e me pedagogët me kohë të plotë, por sidomos ata me kohë të pjesshme, përmes të cilëve diskutohet përgatitja e tyre sipas standardit.

Syllabuset e këtij programi studimi kanë dhe disa rubrika dhe nënrubrika që në tërësinë e tyre jepin një pasqyrë të plotë të lëndës (përshkrimin dhe objektivat), temat javë pas javë, literature (e detyruar dhe ajo ndihmëse), mënyra e vlerësimit për studentin, aktivitetet që parashikohen etj. E detyrueshme është që pedagogët për secilin lëndë duhet ta paraqesin tek grupi i studentëve që në orën e parë në auditor, duke bërë dhe shpjegime për secilin aspekt, si dhe duke iu përgjigjur interesit të studentëve për paqartësi apo informacion shtesë. Syllabus-et ndiqen nga studentët virtualisht përmes sistemit BIS dhe shkarkohen në website-n zyrtar të Kolegjit tek hapësira informative e Departamentit të Shkencave të Komunikimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>KUB ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo parashikohet edhe në nenin 10 të Rregullores mbi studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, në dy profilet.</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe vendimit të akreditimit, i vitit 2013. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një programi “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi me kohë të plotë është 60.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfillte</p>	<p>Programi i ciklit të dytë në Shkencat e Komunikimit, për të dy profilet, i pajis studentët që kanë diplomën e nivelit të parë me njohuri dhe shprehje të thelluara në kërkimin shkencor dhe trajnimin profesional.</p>

<p>profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Kurrikula e programit Master në Shkencat e Komunikimit është vjuese e kurrikulës që studenti e ka zhvilluar në nivelin Bachelor, është një thellim i mëtejshëm i njohurive dhe shprehive në studimin dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Ky program studimi pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Kjo dhe për faktin se studentët që ndjekin dy profilet e programit në pjesën më të madhe janë të punësuar në sektorin e medias apo marrëdhënive me publikun, si një lehtësi e tyre për të bërë hapa cilësore në profesion dhe për të bërë hapa në karrierë.</p> <p>Nga shqyrtimi i kurrikulës së këtij programi që është në fokus, grupi i ekspertëve të jashtëm krijon mendimin se jemi në parametra të qëndrueshëm të përfitimit të njohurive dhe shprehive të kërkimit shkencor si premisë për ndjekjen e nivelit të tretë të studimeve doktorale. Për ata studentë që finalizojnë me rezultate të kënaqshme programin e njërin prej profileve të Masterit në Shkencave të Komunikimit, është i mundur dhe kalimi me sukses i programit të doktoraturës në këto fusha.</p> <p>Nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Shkencave Humane nuk ofrohet ndonjë program studimor “Master profesional”.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Synimet kryesore të programit janë: të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë; të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në media e në sektorin e marrëdhënive me publikun; të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e gazetarit për të informuar publikun në tërësi; të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion; të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës; të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të gazetarisë dhe komunikimit në tërësi; të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.</p> <p>Mënyra e vlerësimit për secilën lëndë janë të përfshira në syllabus-et, të cilat ju prezantohen studentëve që ndjekin këtë program që në fillim të semestrit.</p> <p>Metodat e vlerësimit janë për rezultatet që arrijnë studentët në testin pjesor, projekt individual apo në grup, provim final etj. Për secilën nga këto metoda studenti informohet për propocionin që ka ajo në totalin e vlerësimit.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveqare dhe praktikatat e mira të vendeve</p>	<p>Gjatë bashkëbisedimit me përfaqësues të stafit akademik, me drejtues të Departamentit dhe fakultetit, por dhe nga shqyrtimi i</p>

<p>europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>dokumentacionit mbi kurrikulën e programit Master i shkencave në Shkencat e Komunikimit, për dy profilet, mbështetja ka qenë në përvojat dhe praktikën e arsimit universitar dhe atij pasuniversitar të vendeve evropiane, sigurisht në përshtatje me kontekstin e nivelit dhe perspektivës së vendit tonë në këtë fushë. Ka referenca në modele dhe aplikime të universiteteve a programeve universitare të vendeve evropiane.</p> <p>Programi në fokus të këtij vlerësimi reflekton vlerat më të mira evropiane, duke funksionuar si një model i provuar në garantimin e cilësisë në shkencat e komunikimit. Treguesit e kësaj sipërmarrje si, planet mësimore dhe ato të realizimit të praktikave profesionale, sistemi i kreditimit për rezultatet e studentëve, metodat e vlerësimit për njohuritë dhe shprehitë që ata kanë fituar në këtë program studimi të nivelit të dytë, fluksi i literaturës së rekomanduar për lëndët, infrastruktura në shërbim të mësimdhënies dhe punëve të pavarura etj., janë garanci për konkurueshmërinë e programit ndërkombëtarisht.</p> <p>Programi i studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit, në profilet Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun është hartuar në përputhje të plotë me Kartën e Bolonjës dhe kërkesat e saj.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Për programin e Masterit në Shkencat e Komunikimit kombinohen dy komponentët, kërkimi shkencor dhe aftësimi profesional. Përveç programit që i angazhon ata në procesin e praktikës dhe kontributit në fushën e gazetarisë apo marrëdhëniet me publikun, një pjesë e studentëve janë të punësuar në këto fusha. Njëkohësisht atyre u duhet të angazhohen dhe në detyra a projekte, si dhe në ideimin dhe përgatitjen e tezës, si një investim i tyre në kërkimin shkencor.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ecurinë e programit të studimit në Master i shkencave në Shkencat e Komunikimit, profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike evidentohet përputhja e tyre me profilin e Kolegjit, por dhe përputhja e natyrës dhe konceptimit të Fakultetit të Shkencave Humane, ku përfshihet dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit.</p> <p>Angazhimi i personelit akademik, që është pjesë e programit studimor në fokus, angazhimin në punën kërkimore dhe shkencore e prezanton që në fillim të vitit akademik tek Departamenti, përmes një plani të detajuar në kontributet e pritshme dhe afatet kohore për ecurinë dhe finalizimin e tyre. Ky angazhim bëhet dhe pjesë e diskutimit në Departament në mbledhjet e para dhe atë të mëpasme në vlerësim të rezultateve konkrete.</p> <p>Ky angazhim i personelit akademik të programit Master në Shkencat e Komunikimit, është në përputhje me synimet dhe objektivat e tij, pasi dhe personeli i rekrutuar, qoftë me kohë të plotë, qoftë me kohë të pjesshme është në sinkron me interesin dhe kontributin personal kërkimor dhe shkencor. Pra ka përputhje mes synimeve të programit dhe profilit shkencor të personelit akademik që është i angazhuar aty.</p>
---	--

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë veçanërisht apo të huaj.</p>	<p>Në Departamentin e Shkencave të Komunikimit nuk ofrohen programe studimi “Master profesional”.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi në fokus nga kompozimi dhe dinamika e zhvillimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës , qofshin ata që ndjekin profilin Gazetari apo ata që ndjekin Marrëdhënie me Publikun. Kombinimi i njohurive dhe shprehive teorike me ato praktike krijojnë oportunitet për të diplomuarit që që punojnë në njësitë mediatike, klasike ose ato të reja, por dhe në institucione publike dhe ato private. Një kontigjent prej tyre, ata me rezultate të larta dhe me ambicie për thellimin e njohurive në këto fusha, përfundimi i Masterit në Shkenca Komunikimi është një bazë e mirë për vijimin e studimeve në ciklin e tretë.</p> <p>Gjatë takimeve në Departament si dhe me drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane u njohëm me një studim të nevojave të tregut të punës në lidhje me programet që ofron KUB, dhe i paraqitur në periudhën e licensimit të MASH-i dhe APAAL. Vetë Departamenti ka realizuar një studim mbi vlerësimin e nevojave dhe mundësive në tregun e medias dhe komunikimit në Shqipëri. Këto të dhëna dhe vlerësime kanë ndikuar dhe në kuotat e përcaktuara për dy programet e Departamentit, në Bachelor dhe në Master Shkencor, por dhe duke gjykuar më konkretisht për aspekte të tilla si, gjendjen aktuale të tregut të punës; nevojat për burimet njerëzore; sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballlet ky sektor; drejtimin e aktiviteteve sipas tregut të punës; sugjerime mbi ndryshimet e mundshme në programet mësimore të ofruara nga departamenti, këto me kusht që të përshtaten me trendin që ky treg po ndjek; numrin e studentëve që studiojnë në këto fusha në rang kombëtar; grupet kryesore të medias shqiptare; të dhëna mbi tregun e reklamës, marketingut dhe marrëdhënieve publike etj.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Në tërësinë e tij programi që është në fokus të këtij vlerësimi është në përputhje me interesat kombëtare të vendit tonë. Programi kontribuon dhe nxit për përgatitjen e profesionistëve në fushën e shkencave të komunikimit, duje përfshirë profilet e gazetarisë apo atë të marrëdhënieve publike. Me njohuritë e thelluara dhe shprehite praktike të fituara diplomantët e këtij programi janë të gatshëm për të kontribuar (një pjesë e tyre si e kemi përmendur janë të punësuar) në institucione të fushës së Shkencave të komunikimit apo të përafërta me të, por dhe për ata që kanë rezultate të larta si dhe ambicie për të thelluar më tej njohuritë, ky nivel studimi i krijon mundësinë për të vijuar dhe në nivelin e tretë, për studime doktorale.</p> <p>Programi që është në fokus ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e vlerave</p>

	<p>kombëtare tek studentët që e frekuentojnë atë, si ata që janë banorë brenda territorit të Shqipërisë, ashtu dhe ata që vijnë nga trojet. Departamenti i Shkencave të Komunikimit në KUB ka zhvilluar dhe disa aktivitete në përmbushje të këtij synimi, si mund të përmendim projektin studentor “Një muze për At Gjergj Fishtën”, në viti akademik 2016-2017; projekt tjetër studentor “Një libër më shumë për Preshevën”, në vitin akademik 2017-2018; ndërkohë që në këtë vit akademik që është në proces po realizohet projekti studentor “Ruaj traditën, festo shqip”, një kolazh aktiviteteve për të arritur ndërgjegjësimin e të rinjve për të ruajtur e kultivuar folklorin shqiptar.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Numri 120 i krediteve (ECTS), si dhe 30 ECTS që janë të detyrueshme për përgatitjen dhe finalizimin e tezës’ janë të dhëna që iu jepen studentëve të Masterit në Shkencat e Komunikimit, për dy profilet, që në fillim të vitit të parë në këtë program. Këto elementë përfshihen dhe në Rregulloren e studimeve të Nivelit të Dytë të studimeve në KUB.</p> <p>Po e njëjta gjë ndodh dhe me njoftimin e studentëve për kohëzgjatjen e zhvillimit të programit (2 vjet, 4 semestra). Përmes rregullores, precizohen dhe procedurat e kryerjes së të gjitha detyrimeve për studentin deri në marrjen e diplomës në Master të Shkencave të Komunikimit, në njërin prej profileve, Gazetari ose Marrëdhënie me Publikun.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Syllabus-et pasi shpërndahen virtualisht për secilin nga studentët në adresën e emailit, rreth tyre zhvillohen dhe prezantime e detajizime në takimet e drejtpërdrejta me pedagogun e lëndës. Kjo u pranua nga studentët e këtij programi gjatë kontaktit që pati me ta grupi i vlerësimit të jashtëm. Departamenti i Shkencave të komunikimit kujdeset dhe që studentëve përmes sistemit të informacionit BIS.</p> <p>Për programet e studimit në Master Shkencor, KUB prezantimin e tyre për studentët apo cdo të interesuar e përfshin në faqen zyrtare virtuale të institucionit, por dhe përgatit materiale promocionale të printuara që shpërndahen brenda dhe jashtë ambjenteve të Kolegjit. E njëjta praktikë ndiqet dhe për programin e studimit që është në fokus. Departamenti i Shkencave të Komunikimit shpërndaj informacion rreth programit edhe nga llogari të vetat në rrjetet sociale.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite</p>	<p>Procesi i diplomimit është objekt në fluksin e informacionit që merr cdo student që frekuenton njërin nga dy profilet e Programit Master në Shkencat e Komunikimit në Kolegj. Ky proces është dhe pjesë e Rregullores Themelore të institucionit, ku saktësohen dhe detyrimet</p>

për projektin kërkimor dhe tezën.

që duhet të përmbushë studenti deri në finalizimin e diplomimit të tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ecurinë e programit Master në Shkencat e Komunikimit, për të dyja profilet, evidentohet që sasia e krediteve për të dyja vitet e studimit është 120 ECTS. Ndërkohë që 30 ECTS janë lënë për finalizimin e tezës, kuotë kjo që është kusht për fitimin e diplomës në përfundim të programit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i ciklit të dytë në Shkencat e Komunikimit, për të dy profilet, i pajis studentët që kanë diplomën e nivelit të parë me njohuri dhe shprehje të thelluara në kërkimin shkencor dhe trajnimin profesional. Kurrikula e programit është vjuese e kurrikulës që studenti e ka zhvilluar në nivelin Bachelor, i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Kjo dhe për faktin se studentët që ndjekin dy profilet e programit në pjesën më të madhe janë të punësuar në sektorin e medias apo marrëdhënieve me publikun, si një lehtësi e tyre për të bërë hapa cilësorë në profesion dhe për të bërë hapa në karrierë.

Programet e studimit janë në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim të institucionit, marrin parasysh nevojat dhe kërkesat e tregut të punës si dhe synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare. Programet e studimit të ofruara nga KUB kanë të integruar si aftësimin profesional të studentëve ashtu edhe kërkimin shkencor.

Për programet e studimit në Master i Shkencave, KUB prezantimin e tyre për studentët apo cdo të interesuar e përfshin në faqen zyrtare virtuale të institucionit, por përgatit dhe materiale promocionale të printuara që shpërndahen brenda dhe jashtë ambjenteve të Kolegjit. E njëjta praktikë ndiqet dhe për programin e studimit që është në fokus. Departamenti i Shkencave të Komunikimit shpërndan informacion rreth programit edhe nga llogari të vetat në rrjetet sociale. Programi i studimit në ciklin e dytë Master në Shkencat e Komunikimit, në profilet Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun është hartuar në përputhje të plotë me Kartën e Bolonjës dhe kërkesat e saj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në fillim të çdo viti akademik Kolegji ndjek një paketë masash për mbarëvajtjen e procesit mësimor sipas planeve të miratuara në rang institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë. Objekti kryesor mbetet verifikimi i ngarkesës mësimore për stafin akademik me kohë të plotë apo me të pjesshme, shpërndarja e lëndëve, dorëzimi i syllabuse-eve etj. Një grup pune i emëruar me urdhër të rektorit të Kolegjit ndjek gjithë këtë proces në mënyrë kapilare, në rang fakulteti, departamenti dhe programi konkret studimi në dy nivelet, Bachelor e Master.

Për programin Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, në dy profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike, nga ana e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Departamentit të Shkencave të Komunikimit punohet për kombinimin e teknikave të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë krahas leksioneve dhe seminareve edhe zhvillimin e orëve të hapura të mësimi ku vijnë të ftuar ekspertë nga fusha e gazetarisë e komunikimit, të cilët fokusohen në përvoja konkrete të terrenit, duke analizuar dhe prezantuar problematika e trende. Gjithashtu diskutime dhe prezantime zhvillohen dhe në institucione mediatike, gjatë vizitave të studentëve në njësi mediatike publike ose private. Angazhimi me detyrat e kursit dhe prezantimi i tyre është një tjetër format në kontrollin e njohurive dhe shprehjeve të studentëve në dy vitet e këtij programi, duke i angazhuar ata në një produkt konkret nga tematika që përfshihet në programin e lëndës.

Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në auditor, pedagogët bëjnë në mënyrë sistematike kontroll të njohurive të studentëve, si gjatë diskutimeve në grup ashtu dhe përmes prezantimeve individuale të tyre. Ndiqen format standarde të provimeve të pjesshme si dhe ato finale, ndërkohë që studentët paraqesin dhe projekte në grup ose individuale. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me një rregullore për realizimin e provimeve që zbatohet në të gjithë Kolegjin, përfshirë dhe programin e studimit Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit.

Studentët në fillim të semestrit njihen me format e kontrollit të njohurive dhe strukturë e vlerësimit të tyre për secilën prej lëndëve që do të zhvillojnë. Pjesë e syllabus-it është dhe rubrika e mënyrës së vlerësimit të lëndës, e cila jep të ndarë në përqindje komponentët e notës (provimi pjesor, angazhimi në auditor, projekti ose detyra e kursit etj.). Bazuar në rezultatet që fiton studenti në shlyerjen e detyrimeve përlllogaritjet dhe kreditet sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, ose ECTS.

Duke qenë me grup me numër të vogël studentësh, sidomos profili Marrëdhënie Publike, studentët ndjehen më të përfshirë gjatë seancave të seminareve apo diskutimeve. Studentët në takimin dhe bashkëbisedimin me grupin e ekspertëve të jashtëm u shprehën se vlerësojnë si të favorshëm në procesin e mësimdhënies nivelin e infrastrukturës brenda auditorëve, kushtet akomoduese, sistemet e kondicionimit të ajrit, tabelat interaktive (smart board-et), rrjeti i kompjuterave, aksesit në internet (wi-fi). Salla e multimedias ofron kushte komforte për punën në grup, si dhe atë individuale, duke punuar si në kushtet e një redaksie mediatike apo zyre PR-i.

Për angazhimin e pedagogëve në procesin mësimor dhe teknikat që ata përdorin për mësimdhënien merren vlerësime nga studentët dhe gjatë anketave që ata zhvillojnë dy herë brenda vitit akademik. Mendimet dhe propozimet e studentëve vlerësohen nga departamenti në favor të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu për garantimin e standardeve cilësore nga ana e stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, burimet njerëzore dhe NJSBC-ja organizojnë dhe trajnime eëorkshop-e, sipas pohimeve për grupin e ekspertëve të jashtëm nga ana e stafit akademik që është përfshirë me kohë të plotë ose të pjesshme në Departamentin e Shkencave të Komunikimit në KUB. Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Në standardin që aplikon KUB, varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 18)

Për një student të programit Master në Shkencat e Komunikimit, për të dy profilet, pjesën më të madhe në format e mësimdhënies e zënë orët në auditor për leksionet dhe seminarët, bazuar dhe në të dhënat që janë në tabelë. Pikërisht kjo strukturë e mësimdhënies, reflekton dhe format e vlerësimit të studentëve e cila varion nga njëra lëndë të tjera, si zgjedhje e pedagogut të lëndës.

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 19)

Pedagogu i lëndës përfshin në syllabus-in lëndës, që paraqet në Departament për miratim dhe më pas kur e prezanton tek studentët, pjesën shpjeguese për ato forma kontrolli të njohurive. Rubrika përkatëse në syllabus jep të detajuar nga pedagogu mënyrën e kontrollit sistematik gjatë gjithë semestrit në diskutimet e realizuara në grup ashtu dhe përmes prezantimeve individuale të studentëve, por është dhe kryerja e provimit të pjesshëm dhe atij final. (Në tabelën ilustruese jepet strukturimi i vlerësimit për lëndën “Reklama dhe promovimi”). Por për lëndë të ndryshme ky konfigurim ka dhe ndryshime, varësisht zgjedhjes së pedagogut për proporcionin e përqindjes në zërat vlerësues. E përbashkëta është që provimi final zë përqindjen më të madhe të notës përfundimtare. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës sipas një formati të përcaktuar nga Institucioni. Për efekt të objektivitetit të vlerësimit, forma e kontrollit të programeve të studimit të fakultetit bëhet me shkrim dhe e sekretuar.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 20)

Katër janë format e angazhimit të studentëve në aktivitetet e Departamentit dhe të Fakultetit të Shkencave Humane: për punime shkencore individuale të pedagogëve; për projekte shkencore në rang Departamenti; për projekte shkencore në rang Fakulteti; dhe për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë. Studentët e programit Master në Shkencat e Komunikimit janë aktivizuar dhe në disa veprimtari që ka realizuar Departamenti në formatin e paneleve të diskutimit ose workshop-e, që janë fokusuar tek marrëdhënia e medias me audiencat në epokën digjitale; shoqëria e hapur, demokracia dhe edukimi si armë kundër ekstremizmit; fake news –problem i medias apo i demokracisë; etj.

Nisur nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe dosja e dokumentacionit të paraqitur nga grupi i ekspertëve që janë angazhuar, gjatë shqyrtimit dhe gjatë vizitës në Kolegj, grupi i ekspertëve të jashtë evidentoi përputhje me situatën e formave të mësimdhënies në programin që është në shqyrtim, për mënyrat e vlerësimit nga ana e titullarëve të lëndës, apo dhe për tipologjinë e angazhimit të studentëve në aktivitetet e Departamentit dhe të Fakultetit të Shkencave Humane. Standardet plotësohen për treguesit e përmendur më sipër.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët e përfshirë nga njërin nga profilet e programit të ciklit të dytë në Shkencat e Komunikimit (ashtu si dhe ata në programe të tjera) në KUB, deri në vitin 2015 janë pranuar bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pranimi për këtë kategori studentësh është përshtatur me kërkesat e këtij ligji, procedura që vijnë të aplikohen dhe tani. Procedimi i pranimit të studentëve në çdo vit akademik, kuotat për programin e studimit që është në fokus, kriteret e pranimit etj., – janë pjesë e informacionit që KUB dërgon zyrtarisht pranë MASR-së për të gjithë programet në dy nivelet e studimit.

Për këtë proces Kolegji ka ngritur një zyrë të përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve. Oferta publike për këtë program bëhet e njohur përmes faqes zyrtare të internetit, por dhe broshurave orientuese që shpërndahen brenda dhe jashtë ambjenteve të KUB, përmes takimeve të drejtpërdrejta, panairëve etj. Ditët e Hapura, apo edhe ditët e orientimit për studentët e rinj, janë një formë tjetër e prezantimit të ofertës, të shpjegimeve dhe orientimit për të gjithë ata që shprehin interes në ndjekjen e programit Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen Ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit.

Kushtet për pranimin e studentëve dhe procedurat e përzgjedhjes

Grupi i ekspertëve të jashtëm mori informacion konkret mbi kushtet për pranimin e studentëve në këtë program, si dhe procedurat e përzgjedhjes. Për të dy profilet, Gazetari dhe Marrëdhënie Publike pranohet cilido aplikant, shtetas shqiptar apo i huaj, që ka përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit *Bachelor*. Preferenca është për ata studentë që kanë përfunduar ciklin e studimeve të nivelit “Bachelor” në programin e studimit Shkenca Komunikimi, profili *Gazetari* dhe *Marrëdhënie publike* ose të ngjashëm me këtë program.

Kriteret e pranimit në KUB të studentëve për ndjekjen e programeve të ciklit të dytë të studimeve, (përfshi dhe ata në Master në Shkencat e Komunikimit) janë:

- mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%;
- intervista nga komiteti shkencor i departamentit përkatës, në masën 30%;



- përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit në rregulloret e miratuara nga KUB për programet e ciklit të dytë;
- plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1.

Plotësim të njohurive formuese nuk kërkohet kur studenti aplikant ka kryer për programin apo programet e ciklit të parë Bachelor, si në Shkenca Komunikimi, Gazetari, Media, Gjuhësi, Gjuhë-Letërsi, Filozofi-Sociologji, Gjuhë e Huaj, Psikologji, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe fusha të tjera të ngjashme.

Në rastet kur studentët janë të huaj ose studentë, të cilët kanë përfunduar studimet universitare jashtë Shqipërisë, atyre iu kërkohet të kryejnë ekuivalentimin e diplomës në përputhje me kuadrin legjislativ të vendit tonë për arsimin e lartë. Vetëm kur ta finalizojnë këtë proces, ata fitojnë të drejtën e aplikimit dhe t'i nënshtrohen procedurave dhe kërkasave për pranim në ndjekjen e studimeve në njërin prej profileve të Master në Shkencat e Komunikimit.

Pra, pranohen të ndjekin këtë program (në njërin prej profileve): ata shtetas shqiptarë dhe të huaj, të cilët vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me diplomë "Bachelor" në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar); plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KUB-it; pranojnë të paguajnë e tarifën e përcaktuar nga institucioni.

Numri i pranimeve për vitin e ri akademik bazohet në përlllogaritjen e kuotave që Departamenti i Shkencave të Komunikimit i propozon fakultetit dhe Shkencave Humane dhe pas kalimit në procedurat e brendshme dhe miratimit në KUB, ato i dërgohen zyrtarisht MASR-së.

Nga informacioni që grupi i ekspertëve të jashtëm mori gjatë qëndrimit në KUB, si dhe dokumentacioni që shqyrtoi për procedurat e pranimeve në programin Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit, për të dyja profilet, evidentoi se përmes një komisioni pranimi që ngrihej me vendim të Departamentit të Shkencave të Komunikimit realizohej vlerësimi i dosjeve të aplikantëve. Ky proces vijonte më tej, ku ata që miratoheshin përcilleshin në Dekanatin e Shkencave Humane të KUB. Pas kalimit miratues në Dekanat, atëherë lista me fituesit dërgohej në Zyrën e Sekretarisë Mësimore për aktin e shpalljes së studentit fitues.

Secili prej studentëve të miratuar për ndjekjen e programit të nivelit të dytë depoziton të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën e regjistrimit, ku jepen përcaktimet e kohëzgjatjes së programit, titulli që studenti do të marrë në momentin e diplomimit, pagesa dhe aspekte të tjera të angazhimit të tij në dy vitet e studimit deri në finalizimin me diplomim në njërin prej profileve të programit.

- o përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit në rregulloret e miratuara nga KUB për programet e ciklit të dytë;
- o plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1.

Plotësim të njohurive formuese nuk kërkohet kur studenti aplikant ka kryer për programin apo programet e ciklit të parë Bachelor, si në Shkenca Komunikimi, Gazetari, Media, Gjuhësi, Gjuhë-Letërsi, Filozofi-Sociologji, Gjuhë e Huaj, Psikologji, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe fusha të tjera të ngjashme.

Në rastet kur studentët janë të huaj ose studentë, të cilët kanë përfunduar studimet universitare jashtë Shqipërisë, atyre iu kërkohet të kryejnë ekuivalentimin e diplomës në përputhje me kuadrin legjislativ të vendit tonë për arsimin e lartë. Vetëm kur ta finalizojnë këtë proces, ata fitojnë të drejtën e aplikimit dhe t'i nënshtrohen procedurave dhe kërkasave për pranimit në ndjekjen e studimeve në njërin prej profileve të Master në Shkencat e Komunikimit.

Pra, pranohen të ndjekin këtë program (në njërin prej profileve): ata shtetas shqiptarë dhe të huaj, të cilët vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me diplomë "Bachelor" në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar); plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KUB-it; pranojnë të paguajnë e tarifën e përcaktuar nga institucioni.

Numri i pranimeve për vitin e ri akademik bazohet në përlogaritjen e kuotave që Departamenti i Shkencave të Komunikimit i propozon fakultetit dhe Shkencave Humane dhe pas kalimit në procedurat e brendshme dhe miratimit në KUB, ato i dërgohen zyrtarisht MASR-së.

Nga informacioni që grupi i ekspertëve të jashtëm mori gjatë qëndrimit në KUB, si dhe dokumentacioni që shqyrtoi për procedurat e pranimeve në programin Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit, për të dyja profilet, evidentoi se përmes një komisioni pranimit që ngrihej me vendim të Departamentit të Shkencave të Komunikimit realizohej vlerësimi i dosjeve të aplikantëve. Ky proces vijonte më tej, ku ata që miratoheshin përcilleshin në Dekanatin e Shkencave Humane të KUB. Pas kalimit miratues në Dekanat, atëherë lista me fituesit dërgohej në Zyrën e Sekretarisë Mësimore për aktin e shpalljes së studentit fitues.

Secili prej studentëve të miratuar për ndjekjen e programit të nivelit të dytë depoziton të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën e regjistrimit, ku jepen përcaktimet e kohëzgjatjes së programit, titulli që studenti do të marrë në momentin e diplomimit, pagesa dhe aspekte të tjera të angazhimit të tij në dy vitet e studimit deri në finalizimin me diplomim në njërin prej profileve të programit.

Në tabelën e mëposhtme jepet informacion mbi plotësimin e njohurive formuese para se të nisë Masterin e shkencave në Shkenca Komunikimi, për profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike.

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë	Programi akademik	Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësimi i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	1. Ekonomiks 2. Financë-Bankë 3. Eletronikë 4. Informatikë 5. Teknologji 6. Inxhinieri Ndërtimi 7. Inxhinieri Mekanike 8. Inxhinieri Mjedisi 9. Inxhinieri Kompjuterike 10. Arkitekturë dhe fusha të tjera të ngjashme	1. Hyrje në komunikim masiv 2. Marrëdhënie publike 3. Shkrim raportim lajmi I 4. Shkrim raportim lajmi II	4 ECTS 4 ECTS 4 ECTS 5 ECTS

Mbi një paketë informatash mbi ecurinë dhe dinamikën e kurikulës, studentët njihen sapo fillojnë studimet. Shpjegimet bazike dhe përgjigja për interesimin e atyre që sapo nisin vitin akademik ndihmon ingranimin e tyre në një kohë të shkurtër me programin. Drejtoria e marrëdhënieve me studentët, si dhe drejtuesit e Departamentit pohuan gjatë takimit me grupin e ekspertëve të jashtëm se procesi i asistencës për studentët vijon përgjatë dy

viteve që ata ndjekin programin, përmes orientimit dhe kujdestarisë, ku rol ka dhe Zyra e Sekretarisë Mësimore, e cila afishon njoftime sistematike në mjediset e Kolegjit, ose dërgon virtualisht në adresat e personalizuara të studentëve.

Sapo një student bën regjistrimin dhe kontratën me KUB për ndjekjen e programit të studimit, atij i hapet një llogari e personalizuar email-i, që është dhe një hapësirë e kontaktit dhe informimit për dinamikën e realizimit të programit, të shlyerjes së detyrimeve, të rezultateve për teste, për material që janë pjesë e procesit mësimor, literatures së detyrueshme dhe asaj fakultative etj.

Virtualisht një student në programin Master në Shkencat e Komunikimit, për dy profilet, ka mundësi që të hyjë në hapësirat e website-t të KUB, apo llogari të ndryshme në rrjetet sociale, për informim dhe orientim mbi ndjekjen e kurikulës, si dhe lajmërimi për evente të karakterit kërkimor dhe shkencor, social, kulturor etj. Gjatë takimit me studentët na u demonstrua dhe aksesit që ka secili prej tyre përmes aplikimit të sistemit BIS, ku përdoruesi merrte info dhe njoftime në kohë reale mbi procesin mësimor, mbi aktivitete të ndryshme, kalendari i datave të provimeve, shlyerje ose detyrime të paplotësuara etj. Studentët në takimin me grupin e ekspertëve të jashtëm e vlerësuan si shumë të dobishëm këtë sistem.

Studentët pohuan se ata kishin akses me përfaqësues në mbledhje a takime që zhvillonte Departamenti, por dhe në rang Fakulteti apo Kolegji. Studentët kanë akses përfaqësues dhe në aktivitetin e Senatit Akademik, apo në mbledhjet që mban Njësia e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë.

Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, në KUB funksionon dhe Zyra e planifikimit të karrierës, që funksionon pranë dekanatit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët që ndjekin programin e studimit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Pranimet e studentëve në programin që është në fokus të këtij vlerësimi janë bazuar dhe bazohen dhe në një sërë udhëzimesh që lëshon Ministria mbi procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL privat, si edhe për transferimin e studimeve, udhëzime që kohë pas kohe janë aktualizuar.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 21)

Bazuar në treguesit e nivelit të studentëve që vijnë të ndjekin këtë program studimi evitohet se kontigjenti më i madh është midis mesatares "mirë" dhe "shumë mirë". Në Departament na informuan se mesatarja e pranimit në studimin e nivelit të dytë është një aspekt që shikohet në procesin e pranimeve, në ndihmë të sigurimit të cilësisë së zhvillimit të programit. Në të dy profilet dallohet një stabilitet në nivelin e pranimeve të studentëve nga viti akademik 2013 – 2014.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare (Tabela 22)

Nga të dhënat për punësimin e studentëve pas përfundimit të këtij programi studimi, rreth 80 përqind e tyre kanë arritur që të punësohen në përputhje me diplomën e fituar në KUB. Pjesa më e madhe e studentëve që kur nisnin studimet në këtë program janë të punësuar dhe kjo i ndihmon ata në konkretizimin e njohurive dhe shprehive, por, sic u shprehën dhe gjatë bashkëbisedimit me grupin e ekspertëve të jashtëm, kjo ju jep dhe mbështetje ekonomike dhe financiare për përballimin e kostove gjatë kohës së kryerjes së masterit shkencor.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës Mësimore, apo me drejtues të Departamentit dhe Fakultetit, si dhe nga njohja me dokumentacionin përkatës, grupi i ekspertëve të jashtëm u informua mbi standardin e KUB që lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe

anasjellas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatës. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh.

Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë: njëshmëria e programit të studimit dhe koha e kryerjes së studimeve

KUB ka Rregulloren për transferimin e studimeve, e cila shërmen si bazë për procedurat që ndiqen dhe në Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Drejtuesit e Departamentit na informuan dhe mbi specifikat për rastin e programit Master i shkencave, ku për shkak se marrin lëndë vetëm në tre semestra, ata nuk janë të gatshëm të lëvizin në programe mobilitetesh studentore. Për shkak dhe angazhimeve në jetën profesionale dhe familjare kanë zgjedhur të mos marrin pjesë në programe shkëmbimi. Në një rast një student jashtë Shqipërisë aplikoi program shkëmbimi. Studentja nga Universiteti i Stambollit përmes programit të shkëmbimit “Mevlana Exchange Program”, ndoqi punimin e tezës së diplomës për një semester pranë Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Evidentohet kuotë e papërfillshme e studentëve nga trojet dhe rajoni, që përmes një procesi aktiv komunikimi dhe promovimi të këtij programi studimi mund të shtohet ky kontigjent.

Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela 22)

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, shikohet se rreth 80 përqind e të punësuarave që janë diplomuar në Masterin shkencor të programit të studimit Master në Shkencat e Komunikimit, për të dy profilet, Gazetari dhe Marrëdhënie Publike, punojnë në përputhje me diplomën e fituar, ndërkohë që rreth 20 përqind kanë marrë vend pune jo në përputhje me diplomën e fituar në KUB.

Të dhënat që ishin prezantuar në raportin e grupit të vlerësuesve të brendshëm të KUB, si dhe dokumentacioni që shqyrtoi grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë qëndrimit në institucion, si dhe informacioni që u sigurua nga bisedat dhe kontaktet që u zhvilluan me përfaqësues të ndryshëm në Departament dhe fakultetin e Shkencave Humane nuk kishin mospërputhje në tregues e vlerësime.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe hërton plane të mundshme për ndryshimin e</p>	<p>KUB në rregulloren e institucionit, për të kryer studimet e ciklit të dytë, Master i Shkencave, (përfshirë dhe programin që është në fokus), ka si kusht pranimi për ata studentë që dëshirojnë ta ndjekin, që të kenë fituar së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë në Kolegj bazohet në kërkesat e ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Studentët që kërkojnë të ndjekin studimet në programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, në dy profilet, plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga KUB dhe nga kuadri ligjor që është fuqi, miratuar nga MASR. Krahas përmbajtjes së rregullores së studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, profili <i>Gazetari</i> dhe profili <i>Marrëdhënie publike, grupi i ekspertëve</i> të jashtëm u njoh dhe me disa praktika konkrete dosjesh të studentëve në Zyrën e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Kriteret ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%;

<p>kritere ve të pranimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • intervista nga Komiteti Shkencor i Departamentit përkatës, në masën 30%; • përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë; • plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015. <p>Ky kriter i fundit për pranimit e studentëve është përfshirë dhe në rregulloren përkatëse të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca komunikimi, profili <i>Gazetari</i> dhe profili <i>Marrëdhënie publike</i>, konkretisht në nenin 15.</p> <p>Në takimin me drejtues të Fakultetit dhe të Departamentit, si dhe në Zyrën e Sekretarisë Mësimore në KUB, grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me ndryshimet që bëheshin në kriteret e pranimit të studentëve, herë pas here, me synimin që të përmirësohej cilësia e kontigjentit që ofrohej për ciklin e dytë të studimeve, por gjithmonë ndryshimi bëhej duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi, miratuar nga MASR.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentë që ndiqnin këtë program studimi, ata pohuan se kishin informacion mbi mundësitë për punësim pas finalizimit të diplomimit në Master të Shkencave të komunikimit, njërin nga profilet që ndiqnin. Interesimin më të madh e kishin studentët që nuk ishin ende në marrëdhënie pune ndërkohë që ndiqnin studimet. Në njoftimet që jepeshin dhe përmes webiste-t zyrtar të KUB, si dhe specifikisht të Departamentit të Komunikimit kishte shpjegime dhe për mundësitë për punësim të tyre në këtë fushë.</p> <p>Një student që interesohet për ndjekjen e studimeve në Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, që para se të përgatisë dokumentacionin e aplikimit, i jepet info mbi akreditimin e KUB, apo të programeve, përfshi dhe programin që është në fokus, si dhe vlefshmërinë e diplomës që ai fiton. Këto njohuri janë pjesë e paketës së informacionit që shpërndahet me fletëpalosje, apo në mënyrë virtuale përmes webiste-t zyrtar të KUB. Java e parë e fillimit të vitit akademik në procesin e familjarizimit të studentëve me programin, përfshin dhe këto aspekte të akreditimit apo vlefshmërisë së diplomës që fitohet në përfundimin të studimeve dy vjecare.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe studentëve nga të dyja vitet e programit, grupi i ekspertëve u njoh me shërbimin e këshillimit të karrierës. Konsulenca e Zyrës ishte për teknikat e konceptimit dhe shkrimit të CV-së, të prezantimit të punimeve dhe aktivitetit, orientimin në nevojat që ka aktualisht tregu i punës etj.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon</p>	

statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Zyra e të Diplomuarëve në KUB, si pjesë e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, është e lidhur drejtpërdrejt me studentët që diplomohen dhe me të dhënat mbi punësimin e tyre. Gjatë takimit me përfaqësues të kësaj Zyre, si dhe me Sekretarinë Mësimore në KUB, grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me treguesit statistikorë mbi të diplomuarit, ku mbajtja e treguesve të tillë përcaktohet dhe në rregulloren mbi veprimtarinë e Sekretarisë.

Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore u njohëm me tregues të tillë, si

- numri i studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë;
- rastet e studentëve të tërhequr nga programi;
- rastet e largimit para përfundimit të programit të studimit;
- rastet kur studenti nuk e ka përfunduar me sukses vitin akademik
- Gjithashtu Sekretaria Mësimore ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Sic e përmedëm më sipër Zyra e të Diplomuarëve në KUB, është pjesë e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, dhe e lidhur drejtpërdrejt me studentët që diplomohen.

Kjo Zyrë mban të dhëna në lidhje me të diplomuarit, të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve, si dhe të dhëna mbi punësimin e tyre.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Për studentët ashtu edhe për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ bëhet i njohur procesi i akreditimit. Njoftimi bëhet në mënyrë kapilare nga rektorati deri në njësitë bazë të fakulteteve përmes shkresave të brendshme. Gjithashtu ky informacion shpërndahet dhe përmes faqes zyrtare të internetit të institucionit. Siç është përmendur më sipër, studentët kanë mundësi të informohen dhe mbi programet e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit etj.

Përmes sistemit të informimit të personalizuar, BIS, (Bedër, Information System), studentëve iu shpërndahet rezultati i vlerësimit të ASCAL, aspekte të arritjeve, dinamikës, rekomandime, analiza SWOT etj.

Vlerësimet bëhen dhe objekt diskutimi të hapur me studentët që organizohet nga Departmaneti, si një mekanizëm transparent dhe

	eficent në njohjen e dinamikës aktuale dhe perspektivës së programit të studimit.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjek nga afër ecurinë e studentëve, dhe asiston problematikat që ata hasin në zhvillimin e procesit mësimor në auditor apo jashtë tij.</p> <p>Rëndësi ka dhe planifikimi për zhvillimin e praktikave profesionale, si pjesë e programit mësimor në ciklin e dytë të studimeve. Këtu Zyra e Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me drejtuesit në Departament për të hartuar një listë të institucioneve potenciale për realizimin e praktikës profesionale, e cila konsultohet me studentët për të precizuar caktimin e tyre në secilin prej ofertave që janë në funksion dhe të fushës ku fokusohet më shumë një student. Në programin Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, një pjesë e studentëve janë të punësuar brenda profilit të programit dhe ata e vijnë praktikën profesionale po aty. Të tjerët konsultohen me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Departamentin për tu atashuar në një institucion sa më të përshtatshëm në realizimin e praktikës profesionale.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Studentët që kërkojnë të ndjekin studimet në programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, në dy profilet, plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga KUB dhe nga kadri ligjor që është fuqi, miratuar nga MASR, të zotërojnë së paku një diplomë të nivelit “Bachelor” dhe të kenë përmbushur kriterin e 180 krediteve të fituara.</p> <p>Kriteret bazike janë: mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%; intervista nga Komiteti Shkencor i Departamentit përkatës, në masën 30%; përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë; plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1.</p> <p>Një student që interesohet për ndjekjen e studimeve në Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, që para se të përgatisë dokumentacionin e aplikimit, i jepet info mbi akreditimin e KUB, apo të programeve, përfshi dhe programin që është në fokus, si dhe vlefshmërinë e diplomës që ai fiton. Këto njohuri janë pjesë e paketës së informacionit që shpërndahet me fletëpalosje, apo në mënyrë virtuale përmes webiste-t zyrtar të KUB. Java e parë e fillimit të vitit akademik në procesin e familjarizimit të studentëve me programin, përfshin dhe këto aspekte të akreditimit apo vlefshmërisë së diplomës që fitohet në përfundimin të studimeve dy vjeçare.</p> <p>KUB disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarëve në programet e studimeve që kanë përfunduar dhe mban të dhëna në lidhje me punësimet e studentëve të diplomuar.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në misioni e tij KUB ka të qartësuar se vlerëson dhe mbështet kërkimit shkencor. Kolegji Universitar "Bedër", ka hartuar një udhëzim të veçantë për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, duke mbështetur edhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore. KUB shpërblen efektshmërinë akademike vjetore bazuar në tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse lidhur me performancë në kërkimin shkencor.

KUB ka ngritur Zyrën e Kërkimit Shkencor e cila ka rol koordinimi të aktiviteteve me njësitë e tjera, departamentet dhe studentët. Kolegji KUB stimulon kërkimin shkencor. Ai jep edhe mbështetje financiare për pedagogët e tij për pjesëmarrje në konferenca shkencore. Çdo fillim viti akademik, një shifër deri në 700 euro është në dispozicion të pedagogëve për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kërkimore, konferenca ndërkombëtare dhe publikime. Pedagogët aplikojnë për këtë mbështetje financiare në bazë të kritereve të përcaktuara në "Praktika e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca" dhe "udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor".

KUB ka lidhur marrëveshje dhe bashkëpunon Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe ka nënshkruar Kartën për Studiuesit Evropianë në kuadër të Programit Horizont 2020

Kolegji Universitar BEDER ka një program afatmesëm zhvillimi, Strategjia 2018-2023, pjesë e të cilit është edhe rritja e pjesëmarrjes në kërkimin shkencor, projekte kërkimore, konferenca, publikime, etj.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun është angazhuar në procesin e kërkimit shkencor si nëpërmjet pedagogeve në përfaqeset e tyre personale për rritje dhe kualifikim, ashtu edhe me anë të aktiviteteve (konferenca, workshope, seminare) të realizuara në rang fakulteti dhe KUB. Në fillim të çdo vitit akademik, Departamenti merr nga secili pedagog një plan të aktivitetit të tij dhe publikimeve të planifikuara. Bazuar në rregulloren e KUB (rregullore të kërkimit shkencor BU-DIR-004-AL e publikuar në 01.10.2012) pjesëmarrja në të tilla aktivitete është e përfshirë edhe në ngarkesën e punës së pedagogëve. Departamenti ka realizuar projekte në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive me titull "Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonal përball qasjes online të shërbimeve të tyre". Në kuadër të këtij projekti u zhvillua edhe një konferencë me bashkëpunimin edhe të Universitetit të Tiranës dhe Kolegjin AAB në Prishtinë

KUB, ka filluar procesin e mobilitetit të studentëve. Ky proces është një ndër drejtimet e zhvillimit që KUB synon ta zhvillojë më tej. Shkëmbimet e studenteve kanë qenë me studente në një Universitet në Norvegji dhe Turqi. Gjithashtu një student nga një Universitet i Turqisë bëri një semestër në kuadër të mbrojtjes së tezës së tij pranë Kolegjit Universitar BEDER. Procesi i mobilitetit të studentëve është shumë modest. Ndjehet dhe nevoja për të dinamizuar mobilitetin edhe tek pedagogët. Kjo lidhet para së gjithash me përfshirjen në projekte universitare të përbashkëta në rajon dhe më gjerë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Nga dosja e vlerësimit të brendshëm KUB pasqyron mjaft aktivitete të organizuara si konferenca dhe workshope me tematika të ndryshme, sidomos të lidhura me komunikimin. Kjo është një vlerë e shtuar e këtij Departamenti dhe e punës që ai bën me studentët dhe përgatitjes së tyre si teorike ashtu edhe më njohuritë më të fundit nga zhvillimet e tregut mediatik.

Në mënyrë të përmbledhur aktivitete shkencore të organizuara nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit renditen më poshtë:

- Konferenca e parë Ndërkombëtare me temë "Dimensionet shpirtërore në shkencat humane" 11-13 maj 2012
- Konferenca shkencore: Roli i medias në formimin dhe konsolidimin e identitetit kombëtar
- Konferencën e Dytë Ndërkombëtare në Shkencat Humane me temë "Krizat dhe spiritualiteti 17-19 maj 2013
- Konferenca e Tretë Ndërkombëtare në Shkencat Humane me temë: "Dimensionet socio-ekonomike në ndërtimin e paqes" 16-17maj 2014

- Konferenca e Katërt Ndërkombëtare në Shkencat Humane me temë: “Identiteti, kultura dhe komunikimi” 29-30 maj 2015
- Konferencën e Pestë Ndërkombëtare në Shkencat Humane me temë: “Ekstremizmi në shekullin e 21, Roli i Ligjit, Medias dhe Kulturës”. 27 Maj 2017
- Konferenca Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim me temë: “Industria e medias, trendet, dinamika dhe sfidat” 26-27 Mars 2015- ICMS 2015
- Konferencë Ndërkombëtare në Studimet e Medias dhe Komunikimit 15 dhjetor 2016
- Konferenca Ndërkombëtare: “Historia e medias dhe transformimet mediatike” 23 shtator 2017, Prishtinë/ Kosovë
- Kultura dhe arsiri si ura komunikimi midis Shqipërisë dhe Francës, 27.03.2014
- Workshopi Rajonal me temë “Gjuha mediatike e mediave shqipfolëse”, 03.05.2014
- Të Miturit në Objektivin e Medias, 15 Nëntor 2017
- Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale, Janar 2018
- Fake News, Problem i Medias apo i Demokracisë? 16 Maj 2018
- Konferenca e Katërt Studentore në Shkenca Komunikimi, 13 Qershor 2018
- Projekti kërkimor: “Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre”
- Projekti P2P Challenging Extremism

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Sipas tabelës së dhënë nga KUB janë 71 publikime të realizuara nga stafi i KUB dhe 37 prej tyre (pra me shumë se 50% janë publikime që lidhen me shkencat e komunikimit, mediat e reja, komunikimin kulturor etj.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

KUB ka fituar dy projekte:

- Projekti kërkimor: “Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre” i cili ishte në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive;
- Projekti P2P Challenging Extremism. Ky projekt është pjesë e Iniciativës globale universitare kundër ekstremizmit (Projekti P2P: Challenging Extremism Initiative) që organizohet nga Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti Amerikan i Shtetit, në bashkëpunim me "EdVenture Partners". Shqipëria u përfaqësua në këtë nismë globale nga një ekip studentësh të KUB të cilët kanë organizuar një fushatë nën moton “Bridges to Tolerance” (Ura drejt tolerancës).

Numri i projekteve të zbatuara

KUB i ka zbatuar me sukses të dy projektet e mësipërme. Ato janë zbatuar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit në KUB.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

KUB ka organizuar 9 aktivitete shkencore

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Kanë qenë 174 pjesëmarrës në këto aktivitete

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Kërkimi shkencor në procesin mësimor ka qenë 49

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Kanë qenë 70 studentë që kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor

Numri i Çmimeve Kombëtare: Kanë qenë dy çmime të fituara

Nga dosja e velërësimit të brendshëm dhe vizita në KUB nuk u vunë re ndryshime në raport me projektet. Mbetet për tu evidentuar mjaft pozitivisht përpjekjet e Departamentit të Shkencave të Komunikimit për përfshirje në projekte të ndryshme që ndikojnë pozitivisht në rritjen e kërkimit shkencor, pjesëmarrjen e studentëve në to , duke i shërbyer kështu njohjes me ndryshimet dhe zhvillimet aktive në mediat në vend.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik ka një listë të gjatë publikimesh dhe ato janë të rregullta dhe të përfshira botime serioze të lidhura me projekte zhvillimore. Të dhënat mbi publikimet shkencore të PAE pasqyrohen në raportin vjetor të departamentit Kolegji Universitar “Bedër” e inkurajon mjaft pjesëmarrjen në projekte. Nga lista e projekteve he publikimeve, konferencave, rezulton se janë trajtuar temat e rëndësishme në zhvillimin e medias në vend, dhe me ndikim në shoqëri. PAE jep kështu ndihmesën e tij në zhvillimin e medias në vend.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Në programin “Master i shkencave” në Shkenca Komunikim, me profil Gazetari dhe Marrëdhënie publike, nuk ka lëndë në gjuhë të huaj. PAE ka në dosjet e stafit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore certifikatat për njohjen e gjuhës së huaj.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	NË RVB jepet lista e trajnimeve të stafit të KUB. Vete Institucioni organizon programe kualifikimi profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor sipas tematikave të ndryshme. Është Zyra e BNJ që çdo fillim viti akademik merre kërkesat e njësisve bazë dhe planifikon trajnimet specifike për stafin akademik. Për vitin akademik 2018-2019, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, ka propozuar trajnime si : • Dizajnimi i lëndës dhe hartimi i syllabus-it

	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i teknologjisë digjitale në mësimdhënie • Teknikat e konceptimit dhe të shkrimit të projekteve • Botimi në revista shkencore me faktor impakti të lartë <p>PAE i KUB mbështetet të marrë pjesë në programe trajnuese edhe jashtë vendit. Te dy drejtuesit e Departament të Shkencave të Komunikimit kanë qenë pjesëmarrës në trajnimi jashtë vendit . (Dr.Erlis Çela në programin Study of the US Institute on Journalism and Media (SUSI 2018) dhe Dr.Ramadan Cipuri ka marrë pjesë në nëntor të vitit 2016 në një ëorkshop 5 ditor të organizuar nga CLAYSS për format e mësimdhënies të mbështetura në metodologjinë “service learning”.)</p>
--	--

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

KUB disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Ato janë edhe të publikuara në raportet vjetore të departamenteve si dhe në raportin vjetor institucional. Botime ka edhe specifike në format libri për projektet bashkëpunuese me universitetet dhe organizma të tjerë. Gjithashtu publikimet janë edhe online.

Kolegji Universitar “Bedër” disponon një bazë të dhënash në lidhje me botimet shkencore të realizuara nga njësitë bazë apo personeli akademik. Librat e konferencave të organizuara nga KUB janë të pajisura me numër ISBN dhe janë pjesë e fondit të bibliotekës së institucionit dhe Bibliotekës Kombëtare.

KUB, ka një Rregullore të Promovimit dhe Publikimit të Kërkimit Shkencor. Kub mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si dhe shpërblen performancën akademike vjetore mbi indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse

Zyra e Kërkimit Shkencor në Kolegjin Universitar “Bedër” koordinon dhe informon njësitë /departamentet/ personelin për thirrje të ndryshme për projekte kërkimore.

Gjithashtu Zyra dhe KUB bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe ka nënshkruar kartën për studiuesit europianë në zbatimin të programit Horizont 2020.

Konkluzionet e vlerësimit:

Duke shqyrtuar RVB dhe nga informacionet e marra nga vizita në institucion në lidhje me kërkimin shkencor vërehet se KUB i përmbush standartet e kërkuara mbi këtë kriter.

PAE angazhohet në kërkim shkencor, projekte dhe publikon artikuj, materiale shkencore sipas fushës së tyre të veprimtarisë. Të gjitha këto aktivitete janë të dokumentuara dhe KUB ka një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore dhe projektet. Një rol në këtë drejtim luan edhe Zyra e Kërkimit Shkencor.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar BEDER për realizimin e misionit dhe objektivave të tij, ka bashkëpunuar me si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Bashkëpunim është i sanksionuar edhe si pjesë përbërëse e strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit, "Plani Strategjik 2018-2023", miratuar me Vendimin Nr. 2 të Senatit Akademik të KUB datë 21.03.2018.

KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore të vendit dhe të huaja për të realizuar mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikat studentore. Në shifër janë rreth 60 marrëveshje bashkëpunimi me universitete, institucione të pushtetit lokal, organizma publikë dhe privatë.

Sikurse përshkruhet edhe në pikën 10 Kërkimi Shkencor të këtij raporti, Kolegji Universitar BEDER ndër vite ka organizuar dhjetëra konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit, ku vlen të përmenden bashkëpunimet me Institutin Shqiptar të Medias si edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive. Po kështu ka edhe bashkëpunim me universitete të tjera në realizimin e projekteve të përbashkëta. Nga këto bashkëpunime KUB merr parasysh sugjerimet edhe të studimeve të lidhura me tregun e punës të organizuara nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit. KUB ka marrëveshje bashkëpunim me mjaft media në vend.

Gjithashtu KUB ka patur lektorë të huaj të ftuar nga vende të ndryshme si Franca, Italia, Sllovenia, Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosova, Maqedonia, Kina. Një pjesë e profesorëve të ftuar kanë ardhur në kuadër të marrëveshje të bashkëpunimit me universitete të ndryshme.

KUB synon të thellojë më tej punën edhe për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare si TEMPUS dhe ERASMUS + për t'i shërbyer më tej edhe mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare - 62
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj - 7
 - Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit - 5
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL - 1
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor - 5
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime - 2

Të dhënat numerike tregojnë për një nivel të mirë bashkëpunim pjesëmarrje në projekte dhe në fushën e kërkimit shkencor. Kjo është e mbështetur edhe nga infrastruktura dhe kuadri rregullues ligjor qe e mbështet këtë.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale

- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

RVB tregon një listë të plotë të bashkëpunimit me organizata mediatike si tregu i punës. Lista është thuajse shteruese. Po kështu në RVB tregohen edhe bashkëpunimet me Institucione të tjera joqeveritare, e organizata profesionale siç është Unioni i gazetare të Shqipërisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit nuk ofron program studimi “Master profesional”.</p> <p>Programi “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi me profile; Gazetari dhe Marrëdhënie publike nuk ka të parashikuar praktika profesionale, e cila të jetë e detyrueshme për studentët. Megjithatë KUB ka lidhur marrëveshje institucionale të bashkëpunimi. Studentët e programit Master kanë mundësi të përfitojnë nga marrëveshjet institucionale për të qenë pranë aktorëve të tregut të punës.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Shkëmbimi i informacionit brenda KUB realizohet nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së Informacionit dhe faqes zyrtare të komunikimit.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit zhvillon mbledhje javore për të diskutuar ecurinë e programeve mësimore në mënyrë që i gjithë stafi i departamentit të njihet me problematikat dhe arritjet e kolegëve dhe stafit në departament duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave dhe bashkëpunimit të brendshëm.</p> <p>KUB ka një bazë të fortë institucionale të organizuar dhe rregullore të detajuara të cilat mundësojnë marrjen e informacionit dhe përgjegjësive përkatëse, analizën e vazhdueshme të punës së tyre dhe bashkëpunimin</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të metejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KUB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit si edhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Një rëndësi e veçantë i kushtohet praktikave profesionale organizimi i të cilave mundësohet edhe nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të lidhura nga KUB. Kjo është shumë e dukshme për studentët e shkencave të komunikimit të cilët I zhvillojnë këto praktike edhe gjatë periudhës së verës.</p> <p>Zyra e Projekteve dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë janë një ndërlidhës i këtij komunikimi midis stafit akademik, dhe tregut</p>

	<p>dhe mjedisit profesional jashtë institucionit.</p> <p>KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale. Konferencat vjetore janë kthyer në një bazë të mirë të shkëmbimit të eksperiencave me pedagogë vendas dhe të huaj.</p> <p>Duke e vlerësuar si një proces jetik kooperimin ndërkombëtar, nevojitet forcimi i mëtejshëm i komponentit të pjesëmarrjes në projekte universitare jashtë vendit dhe përfshirja aktive në network-e universitare rajonale apo edhe më gjerë, me fonde të BE a institucioneve të tjera.</p> <p>Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi ka zhvilluar seminarët MarCOM, “Studenti dhe Profesionit” dhe trajnime të tjera profesionale. Gjithashtu Departamenti organizon workshop-et e ndryshme në bashkëpunim me punëdhënësit të ndryshëm me qëllim formimin e studentëve në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës.</p> <p>KUB nuk ka marrëveshje kontraktuale me të tretë për realizimin e programeve të studimit, pasi këto realizohen brenda institucionit.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Pasi u shqyrtuar RVB dhe u zhvilluan takimet ne institucion, vlerësohet se KUB punon për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin me aktorë të biznesit, tregut të punës dhe organizma e institucione të tjera.

KUB ka të institucionalizuar komunikimin e brendshëm të personelit në lidhur me zhvillimet e brendshme, detyrimet, projektet dhe arritjet e përbashkëta.

KUB bashkëpunon edhe me institucione te tjera të Arsimit të Lartë, universitete etj.

PËRMBLEDHJE E REALIZIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi a)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi b)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi c)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi d)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi e)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi f)	Rekomandim i plotësuar
Rekomandimi g)	Rekomandim i plotësuar kryesisht
Rekomandimi h)	Rekomandim i plotësuar

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

Pika të forta

1. Pjesëmarrje aktive e pedagogëve dhe studentëve në konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare
2. Biblioteke fizike dhe ajo online me tituj dhe përditësime të tyre (online *Jstore* dhe sistemin *EBSCO* përbën një tjetër mundësi për sigurim literature të kohëve të fundit.)
3. Muzeu i medias interesant, pjesë për edukimin e zhvillimeve historike në media
4. Qëndrueshmëria e stafit akademik të brendshëm. Ka pedagogë që janë mbi 5 vite në këtë program mësimor.
5. Pedagogët e jashtëm, me kohë të pjesshme PAK janë nga emrat e njohur në fushën e medias në vend. Kjo sjell një benefit për studentët dhe Departamentin duke sjellë tregun real të medias në auditor.
6. Mbështetja financiare e pedagogeve për pjesëmarrje në konferenca.
7. Grupe të vogla studentësh, pra jo grupe masive, gjë që sjell mundësinë për punë më specifike dhe të detajuar me studentët.
8. Bashkëpunimi me mediat dhe organizma të ndryshëm për praktika dhe kërkimin shkencor të studentëve.
9. Sistemi i brendshëm i komunikimit BIS që lehtëson procesin e mësimdhënies dhe krijon interaktivitet midis studentëve dhe stafit.
10. Përqindja e lartë e punësimit të të diplomuarve në profilin përkatës të cilët shërbejnë si PR për programin e studimit.
11. Përfshirja e institucionalizuar e studentëve në Këshillin e Departamentit dhe dëgjimi i zërit të tyre në proceset vendimmarrëse të departamentit.
12. Infrastruktura logjistike dhe IT me kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor.

Pika të dobëta

1. Nevojitet forcimi i mëtejshëm i komponentit të pjesëmarrjes në projekte universitare jashtë vendit dhe përfshirja aktive në network-e universitare rajonale apo edhe më gjerë, me fonde të BE a institucioneve të tjera.
2. Procesi i mobilitetit të studentëve është shumë modest. Ndjehet dhe nevoja për të dinamizuar mobilitetin edhe tek pedagogët. Kjo lidhet para së gjithash me përfshirjen në projekte universitare të përbashkëta në rajon dhe më gjerë.
3. Evidentohet kuotë e papërfillshme e studentëve nga trojet dhe rajoni, që përmes një procesi aktiv komunikimi dhe promovimi të këtij programi studimi mund të shtohet ky kontigjent.
4. Nevoja e rritjes së hapësirave sociale në dobi të studentëve, për shoqërizim të tyre gjatë dhe pas orareve zyrtare të mësimin, si mjedise ku do të mundësohej infrastrukturë në shërbim të nxitjes së shkëmbimit dhe prezantimit të ideve, pikëpamjeve dhe inicativave të ndryshmet.

Mundësitë

1. Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Komunikimi", me profile, që ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit, është një nga pak programet e kësaj fushe të ofruara nga IAL-të jo publike.
2. Procesi i integritit evropian do të krijojë mundësi më të mëdha për studentet exchange, projekte bashkëpunimi dhe projekte të tjera në kuadër të ERASMUS, etj.

3. Progresi teknologjik krijon mundësi për degëzime të reja të gazetarisë/PR që e lidhin atë me shumë me profesione të tjera.
4. Kalimi përfundimtar në transmetime televizive dixhitale, do të krijojë nevojën për projekte kërkimore, për të parë zhvillimin e audiencave, dhe kjo mund të jetë një mundësi që Departamenti të përfshihet më shumë në projekte kërkimore shkencore.
5. Departamenti ofron një perspektivë për t'u kthyer në një Qendër Studimore Mediatike (me projekte kombetare dhe ndërkombetare). Për këtë mund të përdoren njohuritë, stafi dhe bashkëpunimet e arritura deri tani.
6. Rritja e mundësive për punësim të studentëve në profesione të reja/institucione të reja mediatike që po hapen si pasojë e zhvillimeve teknologjike.
7. Ndërtimi i një kampusi të ri, sipas projekt-idesë mund të hapë perspektiva të reja.

Pengesat

1. Gazetaria konsiderohet një profesion që zbehet gradualisht, po zvogëlohet kërkesa për këtë profesion në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.
2. Formatimi ndryshe i profesionit dhe zhvillimet teknologjike kanë rritur përfshirjen e gazetarisë qytetare me anën e portaleve online.
3. Mungesa e programeve të ciklit të tretë, që do të kurorëzonte gjithë “zinxhirin” studimor. Kjo ka zbehur, deri diku, harmonizimin e disa Qendrave kërkimor-zhvillimore, objekt i të cilave është realizimi i veprimtarive mësimore-shkencore, kryesisht në programet e këtij cikli.
4. Emigrimet masive të të rinjve dhe sidomos rënia e numrit të studentëve dhe specifikisht për lëndët sociale
5. Rënia besueshmërisë tek gazetaria për arsye të lajmeve të paverifikuara që përhapen herë pas here në vend, kryesisht nga portalet online. Kjo lidhet me uljen e numrit të studentëve.
6. Informaliteti i tregut të punës në vend, e shprehur kjo edhe në tregun e medias.

Rekomandime:

- a) Kolegji Universitar “BEDËR” dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit duhet të punojnë për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në projekte kërkimore ndërkombëtare universitare. Një tjetër drejtim i rëndësishëm duhet të jetë edhe përfshirja në network-e universitare, pjesëmarrja në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian si ato rajonale apo edhe më gjerë, edhe në bashkëpunim me universitete të tjera
- b) Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, do të sjellë edhe rritje të mobilitetit të studentëve dhe më pas edhe të pedagogëve. Për këtë, Departamenti duhet të investohet më shumë duke shfrytëzuar edhe kontaktet me universitetet e tjera.
- c) Departamenti duhet t'i shtrijë përpjekjet për marketimin e programit Master dhe thithjen e studentëve nga vendet e tjera shqipfolëse.
- d) Kolegji Universitar BEDËR të shikojë mundësinë për rritjen e hapësirave sociale në dobi të studentëve, për shoqërim të tyre gjatë dhe pas orareve zyrtare të mësimt.

SWOT ANALYSIS

Comprehensive analysis based on the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

STRENGTHS

1. Active participation of lecturers and students at national and international conferences.
2. Books' library and online library research access with titles' updates (Jstore online and EBSCO system provides another opportunity for recent literature).
3. Enriched media museum, as an important tool for students' education with the country historical media developments.
4. Stability of academic staff, specially refereeing those with full time contract. There are lecturers who have over 5 years teaching subject in those study programs.
5. Part-time lecturers are among the well-known personalities in the media field in the country. This is to the benefit of the students and the Department at BEDER, especially by bringing the real media market to auditors.
6. Financial support of lecturers/pedagogues to participate in conferences.
7. Classes are made of small groups of students, (not overcrowded classes), which gives opportunity for a more specific and detailed work with the students.
8. Cooperation with media organizations and other institution for the practice and research of students.
9. The BIS, internal communication system facilitates the process of teaching and learning, as well as creates interactivity between students and staff.
10. High percentage of employment of the graduated students in the respective profile. This also serves as PR for the study program.
11. Institutionalized involvement of students in the Department Council. Their voices are heard in the department's decision-making processes.
12. Logistical and IT infrastructure provides very well the necessary conditions to develop a more contemporary teaching process.

WEAKNESSES

1. Further strengthening of the participation in university projects abroad is needed. An active involvement in the regional universities network and beyond, especially with EU funds will be a good asset for students and staff.
2. The student mobility process is very modest. There is also a need to increase the mobility of lecturers/teachers. This is primarily related to the inclusion of joint university projects in the region and beyond.
3. There is a small quota of students to enroll from the Albanian speaking countries and region. Suggestion is that through active communication and program promotion quotas can be added to this contingent.

4. There is a need to increase the entertainment and socialization area to the benefit of students. This will serve to them for socialization during and after the official class hours. This infrastructure will serve the students to better encourage, present and exchange ideas, views and action to be taken.

OPPORTUNITIES

1. The "Master of Science" study program, provided by the Department of Communication Sciences at BEDER is one of the few programs of this kind offered by non-public HEIs.
2. The EU integration process will create greater opportunities for student exchange, cooperation projects and others in the framework of ERASMUS, etc.
3. Technology progress creates opportunities for new forms of journalism and PR, creating better connection to other professions as well.
4. The final transition to digital TV broadcasting creates the need for research projects to look at the development of audiences. This may rise an opportunity for the Department to be involved in scientific research projects.
5. The Department offers a perspective to return to a Media Study Center (with national and international projects). The so far accumulated knowledge, staff and collaborations can be used to this end.
6. Increase student employment opportunities in the new upcoming professions/new media institutions that are emerging as a result of technological developments.
7. Building a new campus, according to the project, can open up new perspectives.

THREATS

1. Journalism is considered a profession that is gradually fading out and the demand for this profession is diminishing at national and international level.
2. The journalist profession is being formatted and shaped differently, mainly due to technology developments and the increased involvement of civic journalism through online portals.
3. Lack of third level study programs at BEDER that would crown the entire "chain" of study. To a certain extent, this has weakened the harmonization of some research and development centers, the object of which is the realization of teaching-scientific activities, mainly in the programs of this cycle.
4. Massive youth emigration and especially drop in the number of students and specifically for social subjects
5. Decrease of trust in journalism due some publication of unverified news items that occasionally spread in the country, mostly from online portals. This is related to lowering the number of students wishing to study in this profession.
6. Informality of the labor market in the country, reflected also in the media market.

Recomandations:

- a) University College BEDER and the Department of Communication Sciences should increase their participation in international university research projects. Another important direction should be the inclusion in the university networks, participation in the EU funded projects, in cooperation with other universities either regional or even wider.
- b) The increased participation in international projects will also increase the mobility of students and later on of the lectors and teachers. The Department and BEDER need to invest more human resources in this by strengthening application and making use of contacts with other universities.

- c) The Department should extend its efforts to market Master's program from other Albanian-speaking countries and enroll students from those areas.
- d) The BEDER University College shall search other opportunities for increasing social spaces for the benefit of students, for their socialization during and after the official hours of instruction.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Arben Muka

Dr. Diana Kalaja

